



# Udhëzuesi i EASO-s për kushtet e pritjes: Standardet e punës dhe treguesit

Shtator 2016



# Udhëzuesi i EASO-s për kushtet e pritjes: Standardet e punës dhe treguesit

Shtator 2016

SUPPORT IS OUR MISSION



This Project is funded by the European Union

*Ky dokument u botua falë asistencës së Bashkimit Evropian nëpërmjet projektit “Mbështetje rajonale për menaxhimin e migracionit me fokus te mbrojtja në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi - Faza II”. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e EASO-s dhe nuk pasqyron domosdoshmërih pikëpamjet e Bashkimit Evropian.*

Neither the European Asylum Support Office nor any person acting on behalf of the European Asylum Support Office is responsible for the use that might be made of the following information.

Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2020

Print	ISBN 978-92-9485-281-6	doi:10.2847/910166	BZ-04-16-813-SQ-C
PDF	ISBN 978-92-9485-283-0	doi:10.2847/49933	BZ-04-16-813-SQ-N

© European Asylum Support Office, 2020

Reproduction is authorised provided the source is acknowledged.

For any use or reproduction of photos or other material that is not under the European Asylum Support Office copyright, permission must be sought directly from the copyright holders.

# Përmbajtja

<b>Lista e shkurtimeve</b> .....	<b>5</b>
<b>Hyrje</b> .....	<b>7</b>
Historiku .....	7
Qëllimi dhe objektivi i udhëzuesit .....	7
Struktura dhe formati i udhëzuesit .....	9
Kuari ligjor .....	9
<b>Si të lexohet udhëzuesi</b> .....	<b>11</b>
Terminologjia .....	12
<b>1. Strehimi</b> .....	<b>13</b>
1.1. Vendndodhja .....	13
1.2. Caktimi .....	15
1.3. Infrastruktura .....	16
1.4. Siguria .....	19
1.5. Zonat e përbashkëta .....	20
1.6. Pastërtia .....	21
1.7. Mirëmbajtja .....	23
1.8. Pajisjet dhe shërbimet e komunikimit .....	23
<b>2. Ushqimi</b> .....	<b>25</b>
<b>3. Veshjet dhe artikujt e tjerë joushqimorë</b> .....	<b>27</b>
<b>4. Dieta për shpenzimet ditore</b> .....	<b>31</b>
<b>5. Kujdesi shëndetësor</b> .....	<b>33</b>
<b>6. Ofrimi i informacionit dhe këshillimi</b> .....	<b>35</b>
<b>7. Identifikimi, vlerësimi dhe reagimi ndaj nevojave të veçanta</b> .....	<b>39</b>
<b>8. Trajnimi i stafit</b> .....	<b>43</b>
<b>Shtojcë — Tabela përmbledhëse</b> .....	<b>45</b>



## Lista e shkurttimeve

<b>FEANI</b>	Fondi Evropian për Azil, Migrim dhe Integrim
<b>DPA</b>	Direktiva 2013/32/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013, rreth procedurave të përbashkëta për akordimin dhe heqjen e mbrojtjes ndërkombëtare (rivendosja)
<b>SPEA</b>	Sistemi i Përbashkët Evropian i Azilit
<b>Rregullorja III e Dublinit</b>	Rregullorja (e BE-së) nr. 604/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 qershor 2013, e cila përcakton kriteret dhe mekanizmat e përcaktimit të Shtetit Anëtar përgjegjës për ekzaminimin e një aplikimi për mbrojtje ndërkombëtare, të depozituar në një prej Shteteve Anëtare nga një shtetas i një shteti të tretë ose nga një person pa shtetësi (rivendosje)
<b>EASO</b>	Zyra Evropiane e Mbështetjes për Azil
<b>Karta e BE-së</b>	Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian
<b>FRA</b>	Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore
<b>SHA</b>	Shtetet Anëtare
<b>OJQ</b>	organizatë joqeveritare
<b>MC</b>	Matrica e cilësisë
<b>DP</b>	Direktiva 2013/33/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013, e cila përcakton standardet e pranimit të aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare (e rishikuar)
<b>SGBV</b>	dhunë me bazë seksuale dhe gjinore
<b>PSP</b>	procedura standarde e punës
<b>MP</b>	i (të) mitur i (të) pashoqëruar
<b>UNHCR</b>	Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët





# Hyrje

## Historiku

Direktiva 2013/33/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013, e rishikuar e cila përcakton standardet e pranimit të aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare (që këtu e poshtë DP:

“duhet të përcaktojë standardet për pritjen e aplikuesve [që] arrijnë të sigurojnë [aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare] një standard dinjitoz jetese dhe kushte jetese të pranueshme në Shtetet Anëtare”<sup>(1)</sup>.

Direktiva jep hapësirë të konsiderueshme për të përcaktuar se çfarë nënkupton standardi dinjitoz i jetesës dhe si duhet të arrihet ai. Në të njëjtën kohë, sistemet kombëtare të pritjes ndryshojnë shumë për sa i përket mënyrës se organizimit dhe modaliteteve për ofrimin e kushteve të pritjes. Si rrjedhojë, standardet e kushteve të pritjes vazhdojnë të ndryshojnë në Shtetet Anëtare të BE-së, çka sjell dallime në trajtimin e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare.

Së fundmi, Programi Evropian për Migrimin<sup>(2)</sup> ka theksuar më tej rëndësinë e një sistemi të qartë për pritjen e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, si pjesë e një politike të përbashkët e të qëndrueshme për azilin në Evropë. Veçanërisht, ajo i referohet nevojës për udhëzime të mëtejshme për përmirësimin e standardeve të kushteve të pranimit në Shtetet Anëtare të BE-së.

Ky udhëzues është zhvilluar pikërisht i mbështetur në këtë kontekst. Procesi i zhvillimit të këtij dokumenti ndjek metodologjinë e përcaktuar të matrica e cilësisë, e hartuar nga Zyra Evropiane e Mbështetjes për Azil (EASO). Dokumenti është hartuar nga një grup pune, i përbërë nga ekspertë të Shteteve Anëtare të BE-së, si dhe nga përfaqësues të palëve të tjera të interesit, në fushën e pritjes dhe të drejtave themelore, përfshirë Komisionin Evropian, Agjencinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) dhe Komisionarin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR). Për më tepër, përpara përfundimit të udhëzuesit është diskutuar me anëtarët e forumit këshillues të EASO-s. Përmbytja e udhëzuesit është këshilluar me Rrjetin i Autoriteteve të Pritjes i EASO-s dhe më pas është miratuar zyrtarisht nga Bordi Menaxhues i EASO-s.

Gjithashtu, duhet pasur parasysh që propozimi i Komisionit Evropian për rishikimin të DP (COM(2016) 465 varianti përfundimtar i datës 13 korrik 2016, i referohet veçanërisht këtyre standardeve të punës dhe treguesve.

## Qëllimi dhe objektivi i udhëzuesit

**Objektivi i përgjithshëm** i këtij udhëzuesi është zbatimit i dispozitave kryesore të DP-së, ndërkohë që sigurohet një standard i përshtatshëm jetese për të gjithë aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare, përfshirë ata me nevoja të veçanta pranimit.

Dokumenti është hartuar për **disa qëllime**:

- në nivel politike, shërben si vegël për mbështetjen e reformës ose zhvillimit dhe shërben si kuadër i caktimit/zhvillimit të mëtejshëm të standardeve të pranimit;
- në nivel pune, mund të përdoret nga autoritetet/operatorët e pranimit për të mbështetur planifikimin/drejtimin e ambienteve të pranimit ose për të mbështetur trajnimin e stafit.

Përveç kësaj, udhëzuesi mund të shërbejë si **bazë për zhvillimin e kuadrove të monitorimit** për të vlerësuar cilësinë e sistemeve të pranimit.

Qëllimi i udhëzuesit nuk është të përshkruajë një metodë për ofrimin e kushteve të pranimit. Si rrjedhojë, përveç rasteve kur shprehet ndryshe, standardet dhe treguesit në këtë dokument zbatohen për ofrimin e kushteve të pranimit material, pavarësisht nëse këto ofrohen në natyrë, si ndihmë financiare ose në formën e kuponëve. Kjo qasje ndjek Nenin 2(g) DP, i cili rendit modalitetet e ndryshme për ofrimin e kushteve materiale të pranimit. Kjo, për shembull, nënkupton që Shtetet Anëtare ose duhet të sigurojnë ofrimin e rrobave në përputhje me standardet e përfshira në këtë udhëzues ose që niveli i ndihmës financiare që ofrohet duhet të jetë i përshtatshëm për të mbuluar shpenzimet e aplikuesit për veshje, sipas standardeve të përfshira në dokument.

Pa shpërfillur fokusin e tij ose ambientet e hapura të pranimit, sipas shpjegimit 8 RCD, objektivi i udhëzuesit përfshin “të gjitha fazat dhe llojet e procedurave që kanë lidhje me aplikimet për mbrojtje ndërkombëtare, në

(1) Direktiva 2013/33/EU e rivendosjes e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013, e cila shtron standardet e pranimit të aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare (që këtu e tutje: RCD), disponohet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32013L0033&from=EN> (shpjegimi 11).

(2) Komunikatë e Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Shoqëror dhe Komitetin e Rajoneve, “Një agjendë evropiane për migrimin”, COM(2015) 240, 13 maj 2015.

të gjitha vendndodhjet dhe ambientet që strehojnë aplikues dhe për sa kohë ata lejohen që të qëndrojnë në territorin e Shtetit Anëtar”<sup>(3)</sup>.

Objekti tematik i udhëzuesit përfshin disa dispozita kryesore të DP-së që formojnë një pjesë të sistemeve kombëtare të pranimit për aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare, siç përvijohet në figurën 1 më poshtë. Në mënyrë specifike, dokumenti fokusohet në ofrimin në natyrë të kushteve të pranimit, identifikimin, vlerësimin dhe reagimin ndaj nevojave të veçanta të pranimit dhe ofrimin e trajnimit të stafit që punon në sistemet kombëtare të pranimit. Konsiderohet që të gjitha standardet në këto seksione janë të rëndësishme për të siguruar ofrimin e kushteve të pranimit, në përputhje me DP-në.




Figura 1. Paraqitja e aspekteve kryesore që mbulohen në këtë udhëzues.

Në udhëzues, treguesit janë integruar në seksione të ndryshme, për të matur nëse janë kryer veprimet e duhura për t'u kujdesur për nevojat e veçanta brenda sistemit kombëtar të pranimit. Njëkohësisht, ky udhëzues nuk hyn thellë në nevojat e aplikuesve me nevoja të veçanta pranimi, p.sh. për fëmijët e pashoqëruar.

Ky udhëzues duhet të konsiderohet si hap dhe përpjekje e parë për të lehtësuar aplikimin e disa dispozitave të RCD-së. Jo të gjitha aspektet që janë brenda qëllimit të DP-së janë trajtuar në këtë dokument, si për shembull reduktimi dhe tërheqja e kushteve të pranimit material, ndalimit, qasjes në shkolla dhe arsimim për fëmijët dhe punësim dhe trajnim profesional për të rriturit dhe procedurat e ankesës. Për më tepër, aspektet që lidhen me integrimin e përfituesve të mbrojtjes ndërkombëtare ose përgatitjen e kthimit të aplikuesve, aplikimi për mbrojtje ndërkombëtare i të cilëve është refuzuar, nuk mbulohet në këtë dokument.

Më e rëndësishmja, udhëzuesi është zhvilluar për funksionimin normal të sistemit të pranimit. Situatat që i përkasin kuadrit të emergjencës, si për shembull përdorimi i dispozitave të Nenit 18(9) DP për strehimin emergjent, janë jashtë objektivit të këtij udhëzuesi. Këto aspekte mund të jenë fokusi i udhëzuesve shtesë dhe/ose veglave që duhet të zhvillohen në të ardhmen.

Përgjegjësia e fundit për zbatimin e këtyre standardeve është e autoriteteve të Shteteve Anëtare dhe shumica e standardeve në këtë udhëzues, do të jenë në veçanti brenda kompetencës së autoriteteve kombëtare të pranimit. Megjithatë, në praktikë janë përfshirë shpesh aktorë të tjerë në ofrimin e kushteve materiale dhe jomateriale të pranimit, përfshirë p.sh. shërbimet e tjera shtetërore, rajonale ose vendore dhe organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare.

Standardet e përfshira në këtë dokument pasqyrojnë praktikën tashmë ekzistuese në Shtetet Anëtare të BE-së. Si e tillë, ajo nuk përpiqet të krijojë një model për sistemin perfekt të pranimit; por përkundrazi, synon të hartojë standarde të miratuara, tregues dhe praktika të mira që zbatohen dhe që arrihen nga të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së.

Më e rëndësishme, në përputhje me frymën e Nenit 4 DP, Shtetet Anëtare mund të paraqesin ose të tërheqin dispozita më të favorshme në fushën e kushteve të pranimit për aplikuesit, sesa ato që përfshihen në këtë udhëzues. Ky dokument nuk duhet të kuptohet në asnjë rrethanë si ftesë për të ulur standardet ekzistuese, por si inkurajim për të arritur të paktën etapat që zhvillohen këtu.

<sup>(3)</sup> Shpjegimi 8 RCD.

## Struktura dhe formati i udhëzuesit

Dokumenti hapet me një seksion të shkurtër me titull “Si ta lexoni udhëzuesin”, i cili fokusohet te sqarimi i koncepteve të përdorura.

Më pas, dokumenti ndahet në tetë seksione, duke u fokusuar në temat e mëposhtme:

1. Strehimi
2. Ushqimi
3. Veshjet dhe artikujt e tjerë joushqimorë
4. Dieta për shpenzimet ditore
5. Kujdesi shëndetësor
6. Ofrimi i informacionit dhe këshillimi
7. Identifikimi, vlerësimi dhe reagimi ndaj nevojave të veçanta
8. Trajnimi i stafit.

Secili seksion përfshin standardet e përbashkëta specifike që zbatohen për sistemet kombëtare të pranimi në të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së. Secili standard çiftohet me treguesit përkatës që lehtësojnë vlerësimin nëse ky standard është arritur. Aty ku nevojitet, te “shënimet shtesë” mund të gjenden sqarime të mëtejshme të treguesit.

Përveç kësaj, një shtojcë përfshin një tabelë që përmbledh të gjitha standardet dhe treguesit e listuar në këtë dokument. Megjithatë, kjo tabelë duhet të konsiderohet në lidhje me dokumentin kryesor, i cili ofron sqarime shtesë (shënime shtesë, praktika të mira) që mbështesin interpretimin e udhëzuesit.

## Kuadri ligjor

Baza ligjore kryesore për këtë udhëzues është leximi i DP në lidhje me Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (këtej e tutje: “Karta e BE-së”). Për më tepër, në zbatimin e këtij udhëzuesi, Shtetet Anëtare duhet të kërkojnë që të sigurojnë pajtueshmëri të plotë me parimet e interesave më të mira të fëmijës dhe të unitetit të familjes, në përputhje përkatësisht me Konventën e vitit 1989 të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore <sup>(4)</sup>.

Përveç kësaj, parimet e mëposhtme janë integrale për standardet dhe treguesit e përfshirë në këtë dokument dhe duhet të vëzhgohen në ofrimin e kushteve të pranimi në sistemet kombëtare:

- **Transparenca dhe përgjegjshmëria.** Ofrimi i kushteve të pranimi duhet të bazohet në rregulla transparente dhe të ndershme dhe në procedurat vendimmarrëse. Pa shpërfillur lidhjen e aktorëve shtesë të përfshirë për implementimin e detyrave specifike në sistemet kombëtare të pranimi (p.sh. organizatat joqeveritare, sektori privat etj.), përgjegjësia e përgjithshme e arritjes së niveleve më të larta të transparencës dhe përgjegjshmërisë bie mbi autoritetin përkatës të pranimi.
- **Pjesëmarrja.** Në përputhje me Nenin 18(8) DP, autoritetet pranuese inkurajohen që të lehtësojnë pjesëmarrjen dhe angazhimin e të gjithë aplikuesve, përfshirë fëmijët, në menaxhimin e aspekteve materiale dhe jomateriale të kushteve të pranimi. Për shembull, pjesëmarrja mund të marrë formën e bordeve këshilluese ose këshillave për të kontribuar në aspekte specifike të lidhur me banimin në ambientet e strehimit, si p.sh. përbërja e vakteve, kalendari i veprimtarive.
- **Jodiskriminimi.** Për të gjithë aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare, do të ofrohet pa diskriminim qasje e barabartë te kushtet e pranimi.
- **Marrja në konsideratë e nevojave të veçanta.** Në këtë rast duhet të merren në konsideratë nevojat e veçanta të pranimi. Përkufizimi “nevoja të veçanta” nuk duhet të kufizohet në kategoritë e aplikuesve që përfshihen në listën jo ekskluzive në Nenin 21 DP (“si p.sh. të miturit, të miturit e pashoqëruar, personat me aftësi të kufizuar, personat e moshuar, gratë shtatzëna, prindërit beqarë me fëmijë të mitur, viktimat e trafikut njerëzor, personat me sëmundje të rënda, personat me çrregullime mendore dhe personat që kanë kaluar tortura, përdhunim ose forma të tjera të rënda të dhunës psikologjike, fizike ose seksuale, si p.sh. viktimat e gjymtimit gjenital femëror”), por duhet të përfshijnë çdo aplikues që shfaq ndonjë nevojë të veçantë pranimi. Në këtë aspekt duhet të merren parasysh faktorë të caktuar si gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual.

<sup>(4)</sup> Shpjegimi 9 RCD.



## Si të lexohet udhëzuesi

Shembull: vlerësimi i vendndodhjes së strehimit		SHPJEGIMI
<b>STANDARDI</b>	<i>Sigurimi i qasjes gjeografike në shërbimet përkatëse, si p.sh. shërbimet publike, shkolla, kujdes shëndetësor, ndihmë sociale dhe ligjore, dyqan për nevojat e përditshme, shërbim larjeje rrobash dhe veprimtari në kohën e lirë.</i>	Standardi përfaqëson praktikën e miratuar bashkërisht dhe pajtueshmëria duhet të “sigurohet” nëpërmjet sistemeve kombëtare të pranimit.
<b>Treguesi</b>	<i>Ambienti gjendet në një distancë të arsyeshme ecjeje në këmbë larg shërbimeve përkatëse dhe infrastruktura e disponueshme është e sigurt për ecje.</i>	Treguesi përfaqëson një vegël për të matur pajtueshmërinë me standardin, pra duke vlerësuar nëse distanca ndërmjet strehimit dhe shërbimeve përkatëse publike mund të konsiderohet “e arsyeshme” si distancë ecjeje në këmbë dhe nëse ekziston infrastruktura e nevojshme.  Treguesit e renditur në secilin standard duhet të kuptohen si të përbashkëta, pa rend hierarkie mes tyre.
<b>Treguesit alternativë</b>	<p><b>Treguesi 1.2(a):</b> Me strehimin ofrohen shërbimet përkatëse. <b>OSE</b></p> <p><b>Treguesi 1.2(b):</b> Ambienti gjendet në një distancë të arsyeshme ecjeje në këmbë larg shërbimeve përkatëse dhe infrastruktura e disponueshme është e sigurt për ecje. <b>OSE</b></p> <p><b>Treguesi 1.2(c):</b> Shërbimet përkatëse qasen nëpërmjet transportit publik dhe kohëzgjatja e udhëtimit është e arsyeshme. <b>OSE</b></p> <p><b>Treguesi 1.2(d):</b> Shërbimet përkatëse qasen nëpërmjet transportit të organizuar, i cili ofrohet nga Shteti Anëtar.</p>	Treguesit alternativë përdoren në situata ku mund të zbatohen opsione të ndryshme për të matur pajtueshmërinë me standardin.
<b>Shënime shtesë</b>	Ky tregues duhet të zhvillohet në lidhje me një distancë maksimale specifike, duke marrë parasysh kontekstin kombëtar dhe ambientin, p.sh. nëse ka apo jo shteg këmbësorësh, nëse zona është shumë kodrinore etj. - për shembull, përgjithësisht 3 km larg shërbimeve publike dhe 2 km larg ambienteve të kujdesit shëndetësor dhe shkollës.	Shënimi shtesë përfaqëson një tregues se çfarë mund të përbëjë një “distancë e arsyeshme ecjeje në këmbë”. Në përputhje me kontekstet e ndryshme kombëtare, zbatueshmëria e “shënimeve shtesë” mund të ndryshojë ndërmjet Shteteve Anëtare të BE-së.
<b>Praktika e mirë</b>	Praktika e mirë për përcaktimin e vendndodhjes së strehimit: <ul style="list-style-type: none"> <li>Konsiderohet praktikë e mirë kufizimi i kohëzgjatjes së udhëtimit me transport publik në maksimumi 1,5 orë ose 1 orë larg kujdesit shëndetësor ose dyqaneve për nevojat e përditshme.</li> </ul>	Së fundmi, dokumenti i referohet “praktikës së mirë” ekzistuese në lidhje me seksionet specifike. Termi “praktikë e mirë” nuk rrjedh nga një vlerësim formal, por bazohet te praktika aktuale në disa Shtete Anëtare. Ndërkohë që në këtë fazë nuk paraqitet një standard i miratuar bashkërisht, sidoqoftë Shtetet Anëtare inkurajohen që të marrin në konsideratë adoptimin e këtyre praktikave të mira në sistemet e tyre kombëtare.

## Terminologjia

Neni 2(g) i RCD-së prezanton konceptet e “ndihmës financiare” dhe “ndihmës për shpenzimet ditore”, si mënyra për ofrimin e kushteve të pranimit. Ndërkohë që dispozita specifikon përdorimin e të parës për ofrimin e ushqimit, strehimit dhe veshjeve (kur nuk ofrohet në natyrë ose nëpërmjet kuponëve), përkufizimi i asaj të fundit është më pak i qartë. Për qëllime të këtij udhëzuesi dhe siç theksohet në tabelën e mëposhtme, termi “ndihma për shpenzimet ditore” i referohet çdo ndihme tjetër që u jepet aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, përfshirë ndihmat për qëllime specifike, të ndryshme nga strehimi, ushqimi dhe veshjet, ose artikuj të tjerë jo ushqimore kur nuk ofrohen në natyrë ose si ndihma monetare për një qëllim jo të specifikuar (në dispozicion të plotë të aplikuesit, e quajtur gjithashtu si “para xhepi”).

Lloji i nevojave të pranimit	Referenca në RCD	Mënyra e ofrimit të kushteve të pranimit
Ushqim, strehim, veshje	Neni 2(g)	<b>Ndihma financiare</b>
		Në natyrë
		Kuponë
Nevoja të tjera thelbësore (p.sh. produkte higjiene, artikuj shkollorë, karrocë invalidësh etj.)	Nuk përmendet qartësisht nga RCD	<b>Dieta për shpenzimet ditore</b>
		Në natyrë
		Kuponë
Artikuj me zgjedhje personale	Neni 2(g)	<b>Dieta për shpenzimet ditore</b>

# 1. Strehimi

## Shënime hyrëse

Ky seksion përbëhet nga disa nën seksione që mbulojnë aspektet e mëposhtme të strehimit:

- Vendndodhja
- Caktimi
- Infrastruktura e ambienteve të strehimit
- Siguria e ambienteve të strehimit
- Zonat e përbashkëta brenda
- Pastërtia
- Mirëmbajtja
- Pajisjet dhe shërbimet e komunikimit.

Secila nga këto nën seksione mbulon aspekte thelbësore të ambienteve të strehimit, të cilat plotësojnë njëra-tjetrën.

Shtetet Anëtare janë të lira të zgjedhin nga lloje të ndryshme strehimi që u ofrohen aplikuesve, për sa kohë merren në konsideratë nevojat e veçanta të pranimit të aplikuesve. Sistemimet e ndryshme ndryshojnë nga qendrat e akomodimit e deri te sistemimet alternative, përfshirë shtëpi private, apartamente, hotele ose ambiente të tjera të përshtatura për të strehuar aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare. Për më tepër, DP u ofron Shteteve Anëtare mundësinë e zgjedhjes së dhënies së strehimit në natyrë ose nëpërmjet ndihmave financiare <sup>(5)</sup>. Në njërin anë, aty ku strehimi ofrohet në natyrë, strehimi duhet të pajtohet me standardet e përmendura në këtë seksion; në anën tjetër, aty ku Shtetet Anëtare zgjedhin që t'u ofrojnë aplikuesve ndihmë financiare për të mbuluar shpenzimet e strehimit, kjo ndihmë duhet t'u lejojë aplikuesve që të përfitojnë strehim që pajtohet me standardet e renditura në këtë seksion.

Në të njëjtën kohë, praktika e Shteteve Anëtare reflekton përdorimin e llojeve të ndryshme të strehimit, në varësi të fazës së procedurës së azilit, përfshi p.sh. qendrat e tranzitit, qendrat e reagimit të parë/fillestar ose ambientet e veçanta për aplikuesit në procedurën e Dublinit. Natyrisht, funksionaliteti i ambienteve mund të ndryshojë, në varësi të periudhës kohore në të cilën synohet që të banojnë aplikuesit. Si rrjedhojë, zbatueshmëria e disa standardeve dhe treguesve të përfshirë në këtë seksion mund të varet nga lloji i strehimit të zgjedhur dhe nga qëllimi i tij (p.sh. banim afatgjatë i aplikuesve, krahasuar me atë afatshkurtër). Sa herë që një standard vlen vetëm me një lloj specifik strehimi, ai do të përmendet.

### Referenca ligjore — strehimi

- Neni 2(c) RCD: përkufizimi i "anëtarëve të familjes"
- Neni 2(g) RCD: përkufizimi i kushteve materiale të pranimit
- Neni 12 RCD: familjet
- Neni 17 RCD: rregullat e përgjithshme për kushtet e pranimit dhe kujdesit shëndetësor
- Neni 18(1) RCD: modalitetet e kushteve materiale të pranimit
- Neni 21 RCD: personat vulnerabël (dispozitat e përgjithshme)
- Neni 23(3) dhe (5) DP: të miturit
- Neni 24(2) RCD: të miturit e pashoqëruar

## 1.1. Vendndodhja

### Shënime hyrëse

Standardet dhe treguesit e përfshirë në këtë seksion i referohen vendndodhjes së ambientit në lidhje me mjedisin. Vendndodhja e strehimit mund të ketë një ndikim të fuqishëm në aspektet e tjera të sistemit të pranimit, përfshirë mundësinë e qasjes në shërbimet përkatëse (p.sh. shërbimeve shëndetësore, ndihmës ligjore ose shërbimeve që lidhen me instanca të ndryshme të procedurës së azilit). Si rrjedhojë, standardet dhe treguesit e përfshirë në këtë seksion lidhen ngushtë me ato të seksioneve të mëposhtme. Kjo do të thotë se zgjedhja e vendit të ngritjes së strehimit duhet të kryhet duke marrë plotësisht në konsideratë aspektet e tjera të kushteve të pranimit që janë përmendur në seksionet e ndryshme të këtij dokumenti.

<sup>(5)</sup> Neni 2(g) RCD.

Njëkohësisht, përkufizimi i disa prej treguesve të përdorur brenda këtij seksioni (p.sh. se çfarë nënkupton një “distançë e arsyeshme ecjeje në këmbë”, një “kohëzgjatje e përshtatshme udhëtimit” ose “rregullsia e transportit të organizuar”) do të varej nga lloji i shërbimit që do të qaset dhe nga shpeshtia e nevojës për t’u qasur në këtë shërbim. Për shembull, aty ku fëmijëve u duhet qasje në shkollë, qasja nevojitet të mundësohet përditë dhe kohëzgjatja duhet të jetë e shkurtër. Njëkohësisht, kohëzgjatja e udhëtimit për të lehtësuar pjesëmarrjen e aplikuesit në intervistën personale mund të jetë më e gjatë, veçanërisht nëse transporti ofrohet nga autoriteti përgjegjës.

Ekziston kuptimi i përgjithshëm që ambientet e strehimit duhet të vendosen në zona të përcaktuara për përdorim rezidencial.

## Standardet dhe treguesit

### **STANDARDI 1: Sigurimi i qasjes gjeografik në shërbimet përkatëse, si p.sh. shërbimet publike, shkolla, kujdes shëndetësor, ndihmë sociale dhe ligjore, dyqan për nevojat e përditshme, shërbim larjeje rrobash dhe veprimtari në kohën e lirë.**

**Treguesi 1.1:** Janë vendosur sisteme specifike për aplikuesit me nevoja të veçanta.

- **Shënime shtesë:** Për shembull, aplikuesit me aftësi lëvizjeje të reduktuar ndjeshëm nuk priten që t’i qasen shërbimet përkatëse duke ecur në këmbë. Në këto raste duhet të organizohet ndryshe.

**Treguesit alternativë** për sigurimin e qasjes gjeografike:

**Treguesi 1.2(a):** Me strehimin ofrohen shërbimet përkatëse. **OSE**

**Treguesi 1.2(b):** Ambienti është gjendet në një distancë të arsyeshme ecjeje në këmbë larg shërbimeve përkatëse dhe infrastruktura e disponueshme është e sigurt për ecje. **OSE**

- **Shënime shtesë:** Ky tregues duhet të zhvillohet në lidhje me një distancë maksimale specifike, duke marrë parasysh kontekstin kombëtar dhe ambientin, p.sh. nëse ka apo jo shteg këmbësorësh, nëse zona është shumë kodrinore etj. - për shembull, maksimumi 3 km larg shërbimeve publike dhe 2 km larg ambienteve të kujdesit shëndetësor dhe shkollës.

**Treguesi 1.2(c):** Shërbimet përkatëse qasen nëpërmjet transportit publik dhe kohëzgjatja e udhëtimit është e arsyeshme. **OSE**

- **Shënime shtesë:** Vlerësimi nëse kohëzgjatja e udhëtimit është e arsyeshme do të kryhet në lidhje me llojin e shërbimit që do të qaset dhe me rregullsinë me të cilën ky shërbim duhet të qaset nga aplikuesi (p.sh. koha që i nevojitet një fëmije të shkojë në shkollë nëpërmjet transportit publik, koha që i nevojitet aplikuesit që të udhëtojë për të intervista personale). Përveç kësaj, duhet të merret parasysh rregullsia e vetë transportit publik, i cili lejon që aplikuesi të përfitojë nga shërbimi duke kryer një udhëtim vajtje-ardhje. Qasja me transport publik duhet të kuptohet si rimbursim i kostove të transportit ose transport falas kur nevojitet si minimum për arsyet e mëposhtme: kujdesin shëndetësor dhe marrjen e mjekimeve, procedurën e azilit dhe ndihmën ligjore dhe arsimimin e fëmijëve të regjistruar në shkollë.

**Treguesi 1.2(d):** Shërbimet përkatëse qasen nëpërmjet transportit të organizuar, i cili ofrohet nga Shteti Anëtar.

- **Shënime shtesë:** Ofrimi i transportit duhet të qartësohet duke specifikuar rregullsinë e transportit që ofrohet nga Shteti Anëtar.

#### **Praktika e mirë për përcaktimin e vendndodhjes së strehimit**

Konsiderohet praktikë e mirë:

- përcaktimi i vendndodhjes së strehimit me qëllim të akomodojë aplikuesit në nivel afatgjatë, me qëllimin për të mundësuar ndërveprimin ndërmjet aplikuesve dhe popullatës vendase, për të shmangur izolimin dhe për të lehtësuar integrimin në aspektin afatgjatë;
- kufizimi i kohëzgjatjes së udhëtimit me transport publik në maksimumi 1,5 orë ose 1 orë larg kujdesit shëndetësor ose dyqaneve për nevojat e përditshme;
- përfshirja e popullatës rezidente vendase në përcaktimin e vendndodhjes së ambientit të strehimit.



## 1.2. Caktimi

### Shënime hyrëse

Pa shpërfillur ekzistencën e sistemeve kombëtare të shpërndarjes, të cilat rregullojnë shpërndarjen e barabartë të aplikuesve në territorin e Shteteve Anëtare, standardet dhe treguesit e përfshirë në këtë seksion duhet të lexohen dhe të zbatohen plotësisht, në përputhje me parimin e unitetit familjar, si dhe me respektin për nevojat e veçanta që mund të kenë aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare.

Më e rëndësishme, pajtueshmëria me këto parime nuk lidhet vetëm pas hyrjes në sistemin e pranimit, por edhe në momentin e ricaktimit ose transferimit të aplikuesve në strehime të ndryshme. Si rrjedhojë, në përputhje me Nenin 18(6) RCD, transferimet e aplikuesve në një ambient tjetër duhet të kryhen vetëm kur të jetë e nevojshme.

### Standardet dhe treguesit

#### **STANDARDI 2: Sigurohuni që të respektohet parimi i unitetit familjar.**

**Treguesi 2.1:** Anëtarët e familjes (në përputhje me përkufizimin e Nenit 2 DP) akomodohen së bashku.

- **Shënime shtesë:** Marrëveshja e anëtarëve të familjes që të akomodohen së bashku është vullnetare. Për të lejuar përjashtime të mundshme, duhet të merren parasysh gjykimet rreth sigurisë.

**Treguesi 2.2:** Familjet me fëmijë akomodohen së bashku, me kusht që kjo të jetë në përputhje me interesat më të mira të fëmijës.

- **Shënime shtesë:** Duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë situatës së fëmijëve të martuar.

**Treguesi 2.3:** Aty ku mundet dhe është e pranueshme, uniteti familjar duhet të respektohet në lidhje me anëtarët e familjes më të gjerë.

- **Shënime shtesë:** Në varësi të organizimeve kombëtare dhe në marrëveshjen e aplikuesve, anëtarët e familjes më të gjerë (përfshirë të afërmit jashtë përkufizimit të Nenit 2(c) DP) mund të akomodohen së bashku.

**Treguesi 2.4:** Një dhomë gjumi caktohet për maksimumi një familje.

- **Shënime shtesë:** Për të respektuar standardet e privatësisë, Shtetet Anëtare duhet të akomodojnë maksimumi një familje në një dhomë gjumi. Objektivi i përkufizimit të familjes do të varet nga praktika e Shtetit Anëtar në fjalë.

#### **STANDARDI 3: Sigurohuni që të merren parasysh nevojat e veçanta kur (ri)caktoni strehim të posaçëm për një aplikues.**

**Treguesi 3.1:** Caktimi i strehimit të posaçëm për aplikuesit bazohet në vlerësimin e nevojave të tyre të veçanta të pranimit.

- **Shënime shtesë:** Në veçanti, caktimi i strehimit për një fëmijë bazohet në vlerësimin e interesave më të mira për fëmijën.

**Treguesi 3.2:** Si rezultat i nevojave të identifikuara të veçanta të pranimit, ekziston mundësia që një aplikues të transferohet.

- **Shënime shtesë:** Në veçanti, gjykimet për sigurinë, si p.sh. në rastin e viktimave të trafikut njerëzor, dhunën seksuale dhe me bazë gjinore, torturën ose format e tjera të rënda të dhunës psikologjike dhe fizike do të bëjnë të nevojshëm ricaktimin e një vend strehimi të ndryshëm për aplikuesin. (shihni standardin 11 dhe treguesin 35.3: Nevojat e veçanta, të cilat bëhen të dukshme në një etapë të mëvonshme, identifikohen dhe vlerësohen në mënyrë të përshtatshme.)

**Praktika e mirë në (ri)caktimin e strehimit për një aplikues**

Praktikë e mirë quhet transferimi i familjeve me fëmijë në moshë shkollë ndërkohë që merren në konsideratë pushimet e shkollës në fund të vitit shkollor.

**STANDARDI 4: Sigurohuni që arsyet specifike dhe objektive të lidhura me situatën individuale të aplikuesit të merren parasysh kur caktoni strehim për një aplikues**

**Treguesi 4.1:** Është ngritur një mekanizëm për të gjykuar nëse ekzistojnë arsye specifike dhe objektive për caktimin e strehimit të posaçëm.

- **Shënime shtesë:** “Situata individuale e aplikuesit” që referohet në standardin më lart, i referohet veçanërisht prejardhjes kulturore, gjuhësore dhe fetare të personit, gjinisë së aplikuesit (p.sh. personat transgjinjorë) dhe gjykimeve individuale të lidhura p.sh. me punësimin, trajnimin profesional ose lidhjet ekzistuese familjare.

### 1.3. Infrastruktura

#### Shënime hyrëse

Përkufizimet e mëposhtme zbatohen në lidhje me standardet dhe treguesit e renditur në këtë seksion:

- “Dhomë (gjumi)”: një dhomë e ndarë, e kufizuar me katër mure, me një derë që mund të mbyllet, një dritare që mund të hapet dhe një tavan. Në qendrat e akomodimit ose në strehimet e tjera të përbashkëta, “dhomat e gjumit” duhet të kuptohen gjithmonë si dhoma që kyçen.
- “Anëtarët e familjes” duhet të përcaktohen në përputhje me Nenin 2(c) DP.

Standardet në këtë seksion në veçanti, duhet të konsiderohen vetëm si standarde minimale.

#### Standardet dhe treguesit

**STANDARDI 5: Siguroni hapësirë të mjaftueshme në dhomë në strehimet e përbashkëta.**

**Treguesi 5.1:** Për secilin aplikues ofrohet një hapësirë minimale prej 4 m<sup>2</sup>.

- **Shënime shtesë:** Ky tregues mund të qartësohet më tej, në varësi të dhomës nëse akomodon aplikues që nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin apo anëtarë familjeje. Edhe moshë duhet të merret parasysh, si p.sh. të strehimit i familjeve me foshnje dhe fëmijë të vegjël. Nëse specifikohet, mund të referoheni në legjislacionin kombëtar që përcakton hapësirën minimale të jetesës për person.

**Treguesi 5.2:** Në lidhje me hapësirën minimale prej 4 m<sup>2</sup> për person, sigurohet një dhomë me lartësi minimale 2.10 m.

**Treguesi 5.3:** Në dhomën e gjumit ka hapësirë të mjaftueshme për të vendosur një shtrat dhe një dollap për secilin aplikues.

- **Shënime shtesë:** Në varësi të sistemit specifik, një tryezë dhe një karrige duhet të jenë pjesë e mobilieve thelbësore dhe duhet të mbahen parasysh, përveç rastit kur ofrohen në ambientet e përbashkëta.

**STANDARDI 6: Siguroni respektimin e privatësisë së aplikuesve në strehimet e përbashkëta.**

**Treguesi 6.1:** Në një dhomë gjumi akomodohen maksimumi gjashtë aplikues individualë.

- **Shënime shtesë:** Numri maksimal i personave që do të caktohen për dhomë gjumi mund të përcaktohet edhe nga kohëzgjatja që kalohet në këtë strehim dhe disponueshmëria e hapësirës shtesë jashtë dhomës së gjumit (hapësira e përbashkët, dhomat e tjera private). Nëse nuk ka mundësi praktike për ta arritur këtë tregues, duhet të gjenden metoda alternative për të siguruar privatësinë.

**Treguesi 6.2:** Për aplikuesit individualë meshkuj dhe femra ekzistojnë dhoma gjumi të ndara dhe nuk ka asnjë mundësi hyrjeje për aplikuesit e seksit tjetër.

- **Shënime shtesë:** Kufizimi i qasjes mund të sigurohet nëpërmjet ambienteve të ndara dhe/ose nëpërmjet kyçeve, pa shpërfillur çështjet e sigurisë së ambientit të pranimit. Në veçanti, dollapët duhet të mbyllën nëse ambienti strehon aplikues me nevoja të veçanta, p.sh. aplikueset femra të cilat mund të jenë të rrezikuara nga dhuna me bazë gjinore.

**Treguesi 6.3:** Parashikohet një dhomë që krijon një ambient privat (brenda ose jashtë godinës) për takimet me ndihmësin ligjor, punëtorin social ose aktorët e tjerë përkatës dhe kjo disponohet për aplikuesit kur nevojitet.

**Treguesi 6.4.** Janë vendosur sistemime specifike për aplikuesit me nevoja të veçanta.

- **Shënime shtesë:** Për shembull, të miturve të pashoqëruar duhet t'u ofrohen dhoma të ndara dhe nuk duhet të banojnë në të njëjtën dhomë me aplikuesit e rritur.

#### Praktika e mirë në lidhje me privatësinë e aplikuesve

Konsiderohet praktikë e mirë ofrimi i një korridorit minimal me të paktën 90 cm hapësirë ndërmjet shtretërve, që të lejohet privatësia.

### STANDARDI 7: Sigurohuni që vendi i strehimit të jetë mobiluar mjaftueshëm.

**Treguesi 7.1:** Mobiliet për çdo dhomë gjumi individuale përfshijnë minimalisht:

**7.1.1:** një shtrat individual për person; **DHE**

**7.1.2:** një dollap për person ose familje, mjaftueshëm i madh për të mbajtur sendet personale (si p.sh. rrobat, ilaçet ose dokumentet).

**Treguesi 7.2:** Në dhomat e gjumit të përbashkëta me aplikues të tjerë që nuk janë anëtarë familjeje, dollapi kyçet, pa shpërfillur çështjet e sigurisë së ambientit të pranimit.

- **Shënime shtesë:** Në veçanti, dollapët duhet të mbyllën nëse ambienti strehon aplikues me nevoja të veçanta, p.sh. aplikueset femra të cilat mund të jenë të rrezikuara nga dhuna me bazë gjinore.

**Treguesi 7.3:** Mobiliet në zonën e përbashkët/të banimit përfshijnë një numër të mjaftueshëm tavolinash dhe karrigesh.

**Treguesi 7.4:** Në ambientet ku aplikuesve u kërkohet të gatujnë vetë, në kuzhinë ofrohen dhe mundësohen si më poshtë:

**7.4.1:** një hapësirë e mjaftueshme në frigorifer për person; **DHE**

- **Shënime shtesë:** Hapësira e mjaftueshme në frigorifer mund të qartësohet duke specifikuar numrin e litrave ose raftet që disponohen për person/familje.

**7.4.2:** një hapësirë e mjaftueshme në raft për person/familje; **DHE**

**7.4.3:** një mundësi minimale për përdorimin e sobës për person/familje; **DHE**

**7.4.4:** një numër minimal pjatash, gotash, enësh gatimi dhe lugësh e pirunësh për person.

**Treguesi 7.5:** Disponohen sistemime specifike për aplikuesit me nevoja të veçanta.

- **Shënime shtesë:** Për shembull, foshnjat duhet të pajisjen me shtrat për bebe, me tryezë ndërrimi dhe karrige të posaçme; personat me aftësi të kufizuar lëvizjeje duhet të pajisjen me mobilie të përshtatura; dhe familjet me fëmijë në moshë shkolllore duhet të pajisjen me një tryezë të madhe dhe një karrige për t'i lejuar fëmijët që t'u përkushtohen detyrave të shtëpisë.

## **STANDARDI 8: Siguroni infrastrukturë sanitare të mjaftueshme, të përshtatshme dhe funksionale në vendin e strehimit.**

**Treguesi 8.1:** Të gjithë aplikuesit duhet të kenë qasje në dush/banjë, në një lavaman me ujë të ftohtë dhe të nxehtë dhe një tualet funksional.

**Treguesi 8.2:** Të paktën një tualet funksional dhe që kyçet për 10 aplikues është i disponueshëm pa kufizime.

**Treguesi 8.3:** Të paktën një dush ose banjë funksionale me ujë të nxehtë dhe të ftohtë ekziston për 12 aplikues dhe është e disponueshme minimalisht 8 orë në ditë.

- **Shënime shtesë:** Raporti i dushit me aplikuesit mund të përshtatet nëse sigurohet disponueshmëria për periudha më të gjata gjatë ditës.

**Treguesi 8.4:** Të paktën një lavaman funksional me ujë të nxehtë dhe të ftohtë për 10 aplikues është i disponueshëm pa kufizime.

**Treguesi 8.5:** Nëse në banjë gjenden më shumë se një dush, duhet të sigurohet ndarje e dukshme.

**Treguesi 8.6:** Ekzistojnë ambiente tualeti, lavamanësh dhe dushesh, të ndara sipas seksit (të dukshme dhe me shenja të kuptueshme), përveç rastit të ambienteve të vogla të strehimit.

- **Shënime shtesë:** Apartamentet, garsonierat dhe vendet e tjera të strehimit për më pak se 12 persona mund të kenë përjashtime.

**Treguesi 8.7:** Për sa i përket strehimit të përbashkët për aplikuesit që nuk janë anëtarë familjeje, janë kryer rregullime që të sigurohet se aplikuesit mund të hyjnë të sigurt te këto ambiente dhe që intimiteti i aplikuesve të respektohet gjatë gjithë kohës.

**Treguesi 8.8:** Janë kryer rregullime për t'u siguruar që rrobat dhe peshqirët të qëndrojnë të thata ndërkohë që aplikuesit bëjnë dush.

**Treguesi 8.9:** Janë vendosur sistemime specifike për aplikuesit me nevoja të veçanta.

- **Shënime shtesë:** Për shembull, për fëmijët nën 2 vjeç ka qasje të përditshëm te banja e bebeve.

### **Praktika e mirë në lidhje me infrastrukturën sanitare**

Konsiderohet praktikë e mirë:

- vendosja e tualetit në të njëjtën ndërtesë me dhomën e gjumit dhe ambientet e përbashkëta dhe jo jashtë;
- sigurimi që ambientet e dushit janë me kyçe individuale dhe që hyrja nuk është e kufizuar me kohë.
- kujdesi ndaj çështjeve gjinore dhe sigurisë së femrave, si p.sh. vendosja e instalimeve sanitare pranë ose në një distancë të sigurt me ndriçim të mirë.

## **STANDARDI 9: Siguroni pajtueshmërinë e vendit të strehimit me rregulloret përkatëse kombëtare dhe vendore.**

**Treguesi 9.1:** Vendi i strehimit është ndërtuar në përputhje me rregulloret vendore dhe kombëtare në fuqi.

**Treguesi 9.2:** Vendi i strehimit mirëmbahet dhe përdoret në përputhje me rregulloret përkatëse vendore dhe kombëtare, duke marrë parasysh të gjitha rreziqet e mundshme.

- **Shënime shtesë:** Më poshtë ka disa shembuj për vlerësimin e ecurisë së arritur drejt standardit në një qendër akomodimi: një plan evakuimi për qendrën e akomodimit është i vendosur dhe i dukshëm gjatë gjithë kohës; rrugët e evakuimit nuk kanë pengesa dhe fiksitet e zjarrit arrihen lehtësisht.

**Treguesi 9.3:** Në dhomat e gjumit dhe zonat e përbashkëta/të ndenjes në vendin e strehimit hyn dritë natyrale dhe ajër i pastër i mjaftueshëm, ndërkohë që kur nevojitet, ekzistojnë perde dhe/ose grila për të bllokuar dritën.

**Treguesi 9.4:** Për të gjitha zonat e shtëpisë ekziston një sistem i përshtatshëm i rregullimit të temperaturës.

- **Shënime shtesë:** *Diapazoni i përshtatshëm i temperaturës do të përcaktohet sipas kushteve të klimës në atë vendndodhje dhe standardeve të përgjithshme që zbatohen për shtetasit e atij vendi.*

**Treguesi 9.5:** Dhomat e gjumit dhe zonat e përbashkëta mbrohen nga zhurma e lartë e ambientit.

- **Shënime shtesë:** *Zhurma e ambientit mund të shkaktohet për shembull nga makineritë, aeroplanët, trenat etj.*

## **STANDARDI 10: Sigurohuni që infrastruktura e brendshme dhe e jashtme e vendit të strehimit që përcaktohet për të akomoduar aplikuesit me mundësi të kufizuar lëvizjeje, t'i përshtatet nevojave të tyre.**

**Treguesi 10.1:** Vendi i strehimit gjendet:

**10.1(a):** në katin përdhes; **OSE**

**10.1(b):** ekziston një ashensor i përshtatur për përdorim nga personat me mundësi të kufizuar lëvizjeje; **OSE**

**10.1(c):** numri i shkallëve nuk e kalon maksimumin, sipas nivelit të mundësisë së kufizuar të lëvizjes.

**Treguesi 10.2:** Rrugët hyrëse të jashtme, si p.sh. rrugicat ose rruga e makinave kanë sipërfaqe të fortë dhe të rrafshët.

**Treguesi 10.3:** Hyrja është ndërtuar për të lejuar hyrjen e aplikuesve me mundësi të kufizuar lëvizjeje.

**Treguesi 10.4:** Dyert dhe korridoret brenda vendit të strehimit janë të gjera mjaftueshëm për përdoruesit e karrigeve me rrota.

**Treguesi 10.5:** Hekurat mbajtës ekzistojnë për mbështetje në dhomat dhe vendet që përdoren nga aplikuesit me mundësi të kufizuar lëvizjeje.

**Treguesi 10.6:** Infrastruktura e përshtatur sanitare ekziston, përfshirë për shembull, dushe pa platforma, hekura mbajtës, lavamanë dhe tualete në lartësi të përshtatshme për përdoruesit e karrigeve me rrota, si dhe sipërfaqja e dhomave të banjës dhe tualetit e përshtatshme për karriget me rrota.

## **1.4. Siguria**

### **Shënime hyrëse**

Duhet të garantohet siguria e duhur e vendit të strehimit, mobileve dhe pajisjeve të saj, në përputhje me legjislacionin dhe rregullat kombëtare në fuqi dhe me synimin e përgjithshëm të garantimit të një mjedisi të sigurt jetese për aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe për personelin që punon në ambientet e strehimit.

### **Standardet dhe treguesit**

#### **STANDARDI 11: Garantoni masa të mjaftueshme sigurie.**

**Treguesi 11.1:** Kryhet rregullisht një vlerësim rreziku, duke marrë parasysh faktorët e jashtëm dhe të brendshëm.

- **Shënime shtesë:** *Faktorët që duhet të merren parasysh për vlerësimin e rrezikut janë: çështjet e sigurisë të shprehura nga aplikuesit, gjendja dhe vendndodhja e vendit të strehimit, sjelljet e komunitetit të banorëve vendas, numri i personave që do të akomodohen, përbërja e kombësive ndërmjet banorëve në qendrën e strehimit, gjinia dhe gjendja familjare e aplikuesve, aplikuesve me nevoja të veçanta që janë akomoduar aty dhe incidentet në të kaluarën.*

**Treguesi 11.2:** Janë prezantuar masa të përshtatshme sigurie, bazuar në rezultatin e vlerësimit të rrezikut.

- **Shënime shtesë:** *Këto masa mund të përfshijnë për shembull: lehtësimin e kontrollit të hyrjes duke ngritur një gardh rreth vendit të strehimit, sigurimin e pranisë së pandalur të një anëtarit të stafit, sigurimin e ndriçimit të vazhdueshëm në zonat e jashtme të ambientit të strehimit dhe një sistem monitorimi me video, që kufizon hyrjen e publikut aty ku nevojitet, për sigurinë e aplikuesve dhe përfshirjen e aspekteve të sigurisë në “rregullat e shtëpisë”.*

**Treguesi 11.3:** Ekziston mundësia të raportoni çështjet e sigurisë (p.sh. vjedhje, dhunë, kërcënime, agresivitet nga komuniteti i jashtë) ndaj personelit përgjegjës në një mënyrë të sigurt.

- **Shënime shtesë:** *Aplikuesit duhet të njoftohen rreth linjës së raportimit në rast incidentesh me sigurinë.*

**Treguesi 11.4:** Numrat e telefonatave të emergjencës janë të afishuara në një vend të dukshëm dhe disponohet edhe një telefon.

**Treguesi 11.5:** Masat e sigurisë fokusohen gjithashtu në zbulimin dhe parandalimin e dhunës seksuale dhe atë me bazë gjinore.

**Treguesi 11.6:** Janë bërë sistemime specifike për aplikuesit me nevoja të veçanta.

- **Shënime shtesë:** *Masat specifike duhet të vendosen për të garantuar sigurinë e të gjithë aplikuesve, veçanërisht të atyre me nevoja të veçanta, në lidhje me moshën e tyre, statusin familjar, gjininë, identitetin gjinor ose orientimin seksual dhe problemet e shëndetit fizik ose mendor. Duhet të vendosen gjithashtu plane specifike sigurie për viktimat e trafikut njerëzor, dhunës seksuale dhe atë me bazë gjinore, torturës ose formave të tjera të dhunës psikologjike dhe fizike. Këto masa mund të përfshijnë për shembull mundësinë për të akomoduar aplikuesit me orientim të ndryshëm seksual veçmas nga aplikuesit e tjerë të të njëjtit seks ose për të transferuar një aplikues që përballet me rrezikun ose që është bërë subjekt i dhunës me bazë gjinore (shihni standardin 3: (Ri)kaktimi i aplikuesve si rezultat i nevojave të tyre të veçanta) ose për të ofruar një hapësirë të mbrojtur për fëmijët që të luajnë pa u rrezikuar. Në ambientet ku strehohen të mitur të pashoqëruar, duhet të vendosen masa specifike parandaluese për të parandaluar humbjen e të miturve.*

#### Praktika e mirë në lidhje me masat e sigurisë

Në qendrat e akomodimit konsiderohet praktikë e mirë:

- krijimi i hapësirave të disponueshme ku grupe specifike të mund të shprehin shqetësimet e tyre të sigurisë në mënyrë private për të inkurajuar raportimin e dhunës;
- për të shfrytëzuar një sistem për regjistrimin ose skedimin e incidenteve me sigurinë.

## 1.5. Zonat e përbashkëta

### Shënime hyrëse

Në kuadrin e këtij udhëzuesi, termi “zona të përbashkëta” i referohet një hapësirë ku aplikuesit hanë dhe kalojnë kohën e tyre të lirë. Madhësia dhe arredimi i zonës së përbashkët, si dhe funksionaliteti i saj, varen nga lloji i strehimit në të cilin gjenden aplikuesit. Si e tillë, “zona të përbashkëta” mund të quhen një ose më shumë dhoma që mund të përdoren nga aplikuesit.

Për sa i përket ambienteve më të mëdha të strehimit, “zona të përbashkëta” mund të quhen një numër dhomash të ndryshme ku secila përmbush qëllime të shumta, p.sh. ngrënien, kryerjen e aktiviteteve në kohën e lirë ose pjesëmarrjen në aktivitetet e tjera të përbashkëta (p.sh. kurset e gjuhës, dhënia e informacionit). Njëkohësisht, ambientet më të vogla mund të kenë një dhomë për shumë përdorime, e cila mund të kthehet në një dhomë ngrënie/ndenjeje ose në një dhomë për kryerjen e aktiviteteve në kohën e lirë, në varësi të nevojës dhe të orës. Duke marrë të mirëqenë që mund të sigurohet privatësi e mjaftueshme, zona e përbashkët e ambienteve më të vogla ose pjesë të saj mund të shërbejnë në mënyrë të barabartë për aplikuesit që të takohen me punonjësit socialë ose këshilluesit ligjorë.

Më e rëndësishme, termi “aktivitete në kohën e lirë” quhen aktivitetet që përfshijnë edhe të rriturit dhe jo vetëm fëmijët. Kjo bazohet në lidhjen e rëndësishme që ekziston ndërmjet mundësisë së aplikuesit për t’u përfshirë në aktivitete në kohën e lirë dhe shëndetit të tyre mendor. Ekzistenca e hapësirës për aktivitete në kohën e lirë ose mundësia e aplikuesve për t’u përfshirë në veprime të përbashkëta (p.sh. kurse gjuhe, seanca informacioni në grup ose aktivitete sportive) shërben për një qëllim të rëndësishëm sepse ndihmon që të ta strukturojë më shumë ditën e tyre dhe si rrjedhojë mund të ndihmojë në uljen e tensioneve që shfaqen kur harxhoni tepër kohë pa bërë asgjë. Kjo është veçanërisht e ngjashme me fazat fillestare të procedurës së azilit kur aplikuesi mund të mos mund të mos jenë në gjendje (akoma) që të hyjnë në tregun e punës ose t’i përkushtohen një trajtimi formal.

## Standardet dhe treguesit

### STANDARDI 12: Sigurohuni që aplikuesit të kenë vend të mjaftueshëm për të ngrënë.

**Treguesi 12.1:** Të gjithë aplikuesit kanë mundësinë të hanë në një vend të caktuar.

- **Shënime shtesë:** Ekziston mundësia që të gjithë pasagjerët të hanë në një tavernë (në një ambient më të madh) ose në një dhomë ku ka një tryezë dhe shumë karrige. Vendi i ngrënies mund të ketë gjithashtu edhe funksione të tjera, për sa kohë që bëhet i disponueshëm në orë të caktuara.

### STANDARDI 13: Sigurohuni që të gjithë aplikuesit të kenë hapësirë të mjaftueshme për aktivitete në kohën e lirë dhe në grup.

**Treguesi 13.1:** Një zonë e përshtatshme për aktivitetet në kohën e lirë ekzistojnë brenda vendit të strehimit ose pranë, brenda hapësirës publike.

- **Shënime shtesë:** Gjinja, moshja dhe nevojat kulturore dhe fetare të aplikuesve duhet të merren parasysh kur ardoni dhomat për aktivitete në kohën e lirë në vendet e përbashkëta të strehimit. Nëse mundet, kjo mund të përfshijë dhoma të ndara ose orë gjatë së cilave mund të përdoren dhomat që përcaktohen për aktivitete në kohën e lirë.

**Treguesi 13.2:** Aty ku aktivitetet në grup organizohen nga Shteti Anëtar, disponohet hapësirë e mjaftueshme dhe e përshtatshme, për shembull në formën e një dhome të veçantë.

- **Shënime shtesë:** Termi “aktivitet në grup” quhet për shembull kursi i gjuhës, seancat e informacionit në grup, aktivitetet sportive etj.

**Treguesi 13.3:** Nëse ambienti strehon fëmijë, ekziston një dhomë/zonë e sigurt që ata të luajnë dhe të përfshihen në aktivitete në ajër të pastër, brenda vetë strehimit ose në një hapësirë publike pranë.

#### Praktika e mirë në lidhje me zonat e përbashkëta

Konsiderohet praktikë e mirë sigurimi i pranisë së mbikëqyrrur të fëmijëve në hapësira të përshtatshme për fëmijët gjatë kohës që prindërit marrin pjesë në aktivitete në grup.

## 1.6. Pastërtia

### Shënime hyrëse

Termi “pastërti” i referohet procesit të mbajtjes së vendeve të pastra nga papastërtia, infeksioni, sëmundjet etj., duke pastruar dhe hequr mbeturinat. Në përputhje me këtë, termi “e pastër” i referohet mungesës së parazitëve, insekteve, mikrobeve dhe rreziqeve të tjera. Standardet sanitare në fuqi, të përmendura në këtë seksion vlejnë për të gjithë vendin e strehimit, përfshi zonat private, si dhe zonat e përbashkëta që gjenden brenda vendit të strehimit ose atyre jashtë (nëse ka). Në varësi të kontekstit kombëtar, zhvillimi dhe monitorimi i këtyre standardeve mund të jetë përgjegjësi e autoriteteve të tjera përkatëse (p.sh. organeve mbikëqyrëse sanitare).

Në ambientet më të mëdha, “zonat private” quhen vetëm dhomat e gjumit, kurse të gjitha dhomat e tjera që mbeten bien në kategorinë e zonave të përbashkëta. Sidoqoftë, standardet sanitare ndryshojnë ndërmjet llojeve të ndryshme të zonave të përbashkëta, si p.sh. kuzhina, zonat sanitare dhe dhomat e tjera, përfshirë zyrat ose dhomat e aktiviteteve.

Në anën tjetër, në ambientet më të vogla, kuzhina, banja dhe dhomat e tjera duhet të konsiderohen gjithashtu si zona private.

Ndërkohë që mirëmbajtja e standardeve të përshtatshme sanitare bie në përgjegjësinë e përgjithshme të autoriteteve përkatëse në Shtetet Anëtare, edhe aplikuesit mund të përfshihen. Në praktikë, këta të fundit prirën që të jenë përgjegjës për pastrimin e zonave private. Përveç kësaj, në varësi të legjislacionit/rregulloreve kombëtare, edhe zonat e tjera mund të pastrohen nga aplikuesit në mënyrë vullnetare. Në disa raste, kjo mund të kompensohet si pjesë punësh të vogla që jepen brenda strehimit të përbashkët. Në këto raste, procesi i pastrimit duhet të mbikëqyret nga organi përgjegjës ose nga një shoqëri e posaçme pastrimi.

Te rregullat e shtëpisë duhet të shkruhet edhe një përshkrim i detajuar i përgjegjësive në lidhje me pastërtinë e strehimit.

## Standardet dhe treguesit

### **STANDARDI 14: Sigurohuni që zonat private dhe të përbashkëta të qëndrojnë të pastra.**

**Treguesi 14.1:** Ambienti i strehimit zbaton një grafik pastrimi.

- **Shënime shtesë:** Për secilën zonë specifikohet se sa shpesh dhe në çfarë standardi duhet të pastrohet.

**Treguesi 14.2:** Pastërtia e zonave private dhe të përbashkëta të strehimit kontrollohet rregullisht.

- **Shënim shtesë:** Kontrollat marrin në konsideratë nevojën e aplikuesve për privatësi.

**Treguesi 14.3:** Pastërtia kontrollohet kur personat kalojnë në një dhomë tjetër ose në një ambient tjetër strehimi.

**Treguesi 14.4:** Aty ku aplikuesit janë përgjegjës për pastrimin, ata kanë qasje në produktet dhe artikujt e nevojshëm të pastrimit, si dhe në pajisjet mbrojtëse, të tilla si dorezat dhe maskat.

#### **Praktika e mirë në lidhje me sigurimin e pastërtisë së zonave private dhe të përbashkëta**

Konsiderohet praktikë e mirë kur në qendrat e akomodimit paraqitet një grafik pastrimi, i shkruar në mënyrë të qartë dhe të dukshme dhe që dallohet nga aplikuesit.

### **STANDARDI 15: Sigurohuni që kuzhina dhe zonat sanitare të qëndrojnë të pastra.**

**Treguesi 15.1:** Pastërtia e zonave është në përputhje me standardet dhe rregulloret vendore dhe kombëtare.

- **Shënime shtesë:** Këto rregullore, mund t'u referohen për shembull punëve të zakonshme për ndalimin e brejtësve dhe parazitëve.

**Treguesi 15.2:** Zonat pastrohen të paktën çdo ditë (në qendrat e akomodimit) ose aq shpesh sa nevojitet.

**Treguesi 15.3:** Pastrimi në thellësi i zonave kryhet rregullisht.

- **Shënime shtesë:** Në qendrat e akomodimit, ky pastrim i detajuar mund të kryhet të paktën katër herë në vit. Standardet e pastërtisë së kuzhinave që përdoren nga aplikuesit ose për gatim profesional ndryshojnë.

### **STANDARDI 16: Sigurohuni që aplikuesit të mund t'i lajnë vetë rrobat e tyre ose t'i dërgojnë për larje rregullisht.**

**Treguesi 16.1:** Kur ofrohen në natyrë çarçafë krevatesh dhe peshqirë dhe ato lahen nga ambienti i strehimit, ato duhet të lahen rregullisht.

- **Shënime shtesë:** Si minimum, kjo duhet të kryhet çdo 2 javë për çarçafët dhe një herë në javë për peshqirët.



**Treguesit alternativë:**

**Treguesi 16.2(a):** Aplikuesit duhet të jenë në gjendje të lajnë rrobat të paktën një herë në javë. **OSE**

- **Shënime shtesë:** Ky treguesi mund të qartësohet në kontekstin kombëtar duke specifikuar numrin e lavatriçeve dhe mundësinë e përshtatshme për t'i tharë rrobat sipas një numri të caktuar personash.

**Treguesi 16.2(b):** Disponohet një shërbim larjeje rrobash për aplikuesit.

- **Shënime shtesë:** Shërbimi i larjes së rrobave duhet të jetë i disponueshëm mjaftueshëm, për shembull në minimalisht 5 ditë në javë (përfshirë fundjavën).

## 1.7. Mirëmbajtja

### Shënime hyrëse

Në këtë seksion, termi “mirëmbajtje” duhet të kuptohet si grup aktivitetet që kërkohen dhe ndërmerren për të ruajtur gjendjen fillestare të vendit të strehimit sa më shumë dhe sa më gjatë që të jetë e mundur.

Ndërkohë që mirëmbajtja e ambientit të pranimit është përgjegjësi e përgjithshme e autoriteteve përkatëse në Shtetet Anëtare, aplikuesit mund edhe të përfshihen vullnetarisht, nëse lejohet nga legjislacioni/rregulloret vendore. Në disa raste, kjo mund të kompensohet si pjesë punësh të vogla që jepen brenda strehimit të përbashkët. Në këto raste, procesi duhet të mbikëqyret nga organi përgjegjës ose nga një shoqëri e posaçme, përgjegjëse për punët e mirëmbajtjes.

### Standardet dhe treguesit

#### **STANDARDI 17: Garantoni sigurinë dhe funksionimin e duhur të ambienteve të strehimit nëpërmjet mirëmbajtjes së rregullt.**

**Treguesi 17.1:** Funksionimi i mirë i vendit të strehimit dhe mobilieve dhe pajisjeve të tij vlerësohet rregullisht.

- **Shënime shtesë:** Këto kontrole duhet të kryhen të paktën çdo vit. Kur kryeni vlerësimin, mund t’ju vijë në ndihmë një listë kontrolli.

**Treguesi 17.2:** Aplikuesit kanë mundësinë që të raportojnë nëse ka nevojë për mirëmbajtje dhe riparime.

**Treguesi 17.3:** Riparimet dhe zëvendësimet e nevojshme brenda vendit të strehimit kryhen në kohë dhe me cilësinë e duhur.

- **Shënime shtesë:** Pa shpërfillur faktin që përgjegjësia e përgjithshme për mirëmbajtjen e vendit të strehimit është e autoritetit të pranimit, disa punë mirëmbajtjeje mund të kryhen nga aplikuesit si pjesë e punëve të vogla — me kusht që këto të kompensohen dhe të caktohen në mënyrë vullnetare. Mbikëqyrja e përgjithshme duhet të kryhet gjithmonë nga organi përgjegjës.

## 1.8. Pajisjet dhe shërbimet e komunikimit

### Shënime hyrëse

Komunikimi luan një rol të rëndësishëm për aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare nëpërmjet procedurës së pranimit. Termi “komunikimi” përfshin, edhe komunikimin në lidhje me gjendjen procedurale të aplikuesit, ashtu dhe komunikimin privat, për shembull me anëtarët e familjes. Më e rëndësishme, qasja e përshtatshme në komunikim mund të ndihmojë shëndetin mendor të aplikuesve, sepse mund të ndihmojë në parandalimin e ankthit që vjen si rezultat i mungesës së kontaktit me anëtarët e familjes dhe miqtë që ka lënë në vendin e origjinës ose në tranzit, ose që nuk kanë qasjen e duhur për të komunikuar me organizatat që ofrojnë ndihmë ligjore ose shërbime të tjera të ngjashme. Në çdo rast, atëherë kur mundet, aplikuesit duhet të mund të njoftojnë rreth vendimit nëpërmjet postës.

#### Referencat ligjore — pajisjet dhe shërbimet e komunikimit

- Neni 18(2)(b) RCD: modalitetet e kushteve materiale të pranimit

## Standardet dhe treguesit

### **STANDARDI 18: Sigurohuni që aplikuesit të kenë qasje të përshtatshme të telefonit për të bërë thirrje në lidhje me çështjet procedurale, ligjore, mjekësore dhe arsimore.**

**Treguesi 18.1:** Qasja në telefon është e mundur të paktën për thirrje në lidhje me çështjet procedurale, ligjore, mjekësore ose arsimore.

**Treguesi 18.2:** Aplikuesit kanë qasje të përditshme në të paktën një telefon për njësi strehimi.

- **Shënime shtesë:** Numri i telefonave që do të instalohen në godina do të varet nga numri i aplikuesve që banojnë aty.

**Treguesi 18.3:** Aplikuesit mund të kryejnë thirrje në një ambient privat, pra aplikuesit e tjerë nuk mund ta dëgjojnë bisedën.

### **STANDARDI 19: Sigurohuni që aplikuesit të kenë qasje të përshtatshme në internet.**

**Treguesi 19.1:** Aplikuesit kanë qasje në internet në vetë vendin e strehimit ose në një hapësirë publike pranë, të paktën katër herë në javë.

- **Shënime shtesë:** Qasja në internet në vendin e strehimit mund të lehtësohet, ose nëpërmjet disponueshmërisë së një rrjeti me valë (wi-fi) për aplikuesit me pajisjet e tyre personale të komunikimit (p.sh. telefona inteligjentë), dhe nëpërmjet disponueshmërisë së një numri të përshtatshëm kompjuterësh për një numër të caktuar personash. Nëse qasja në internet ofrohet jashtë vendit të strehimit, ai duhet të jetë i disponueshëm në distancë ecjeje në këmbë ose me transport publik (shihni standardin 1: Vendndodhja). Qasja në internet nuk duhet medoemos të jetë pa pagesë (shihni treguesin 28.4: Dieta për shpenzimet ditore).

### **STANDARDI 20: Sigurohuni që aplikuesit të kenë mundësi të ngarkojnë pajisjet e tyre të komunikimit.**

**Treguesi 20.1:** Ekziston të paktën një prizë e disponueshme dhe e arritshme për dhomë gjumi, në mënyrë që të ngarkohen pajisjet elektronike.

#### **Praktika e mirë në lidhje me lehtësimin e qasjes në pajisjet dhe shërbimet e komunikimit**

Konsiderohet praktikë e mirë:

- t'u ofrohet mundësia aplikuesve që të kopjojnë ose të printojnë pa pagesë dokumente që kanë lidhje me procedurën e azilit ose çështjet mjekësore;
- për të lehtësuar qasjen në një televizor me kanale minimalisht në dy gjuhët më të përhapura ndërmjet aplikuesve në vendin e caktuar të strehimit (shihni treguesin 13.1: Zonat e përbashkëta).

## 2. Ushqimi

### Shënime hyrëse

Termi “ushqimi”, siç quhet në këtë seksion, përfshin ushqimin, si dhe pijet joalkoolike. Duke ndjekur të njëjtën rrugë si me seksionin rreth strehimit, standardet e përfshira në këtë seksion duhet të merren në konsideratë, pavarësisht nëse aplikuesve u ofrohet ushqim në natyrë ose në formën e ndihmave financiare ose kuponëve. Kjo do të thotë se Shtetet Anëtare që zgjedhin t’u ofrojnë aplikuesve ndihmë financiare ose kuponë për të mbuluar kostot e ushqimit, duhet të sigurohen që ato janë të mjaftueshme për t’u lejuar aplikuesve që të blejnë ushqim që pajtohet me standardet e renditura në këtë seksion.

#### Referenca ligjore — ushqimi

- Neni 2(g) RCD: përkufizimi i kushteve materiale të pranimit

### Standardet dhe treguesit

#### **STANDARDI 21: Sigurohuni që aplikuesit të kenë qasje në ushqim të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm.**

**Treguesi 21.1:** Zbatohen standardet e sigurisë së ushqimit.

- **Shënime shtesë:** Në përputhje me trajtimin e analizës së rrezikut dhe pikës kritike të kontrollit (HACCP) <sup>(6)</sup> për sigurinë e ushqimit, e zhvilluar nga Organizata e Ushqimit dhe Agrikulturës e Kombeve të Bashkuara (FAO), pastrimi i vendit të strehimit, veçanërisht e zonave të kuzhinës duhet të ndjekë një trajtim parandalues sesa korrigjues. Në përputhje me këtë standard, duhet të sigurohet pastërtia e zonave të kuzhinës, sepse mungesa e pastërtisë mund të sjellë rrezik për shëndetin e përgjithshëm në zonën e strehimit.

**Treguesi 21.2:** Të paktën tre vakte në ditë serviren për të rriturit dhe pesë për të miturit, nga të cilat të paktën njëra gatuhet dhe serviret e ngrohtë.

**Treguesi 21.3:** Vaktet sigurojnë një dietë të ekuilibruar dhe me variacion, duke përfshirë qumësht për të miturit dhe foshnjat, kur nevojitet.

- **Shënime shtesë:** Përbërja e vaktit ndryshon, për shembull vaktet bazohen në drithëra, bukë dhe oriz, fruta dhe perime, qumësht, produkte bulmeti, mish, vezë ose peshk.

**Treguesi 21.4:** Aplikuesit informohen rreth përbërjes së vaktit.

- **Shënime shtesë:** Informacioni mund të jepet në mënyrën e përgjithshme (me etiketa etj.) ose sipas kërkesës.

**Treguesi 21.5:** Janë bërë plane specifike për aplikuesit me nevoja të veçanta diete.

- **Shënime shtesë:** Për shembull, duhet të merren parasysh gratë shtatzëna ose që japin gji dhe personat me sëmundje të caktuara dhe alergji ndaj ushqimeve.

**Treguesi 21.6:** Merren parasysh edhe preferencat e ngrënies dhe kufizimet në dietë për grupe specifike.

- **Shënime shtesë:** “Grupe specifike” quhen aplikuesit nga prejardhje fetare dhe/ose kulturore specifike, si dhe aplikuesit vegjetarianë/veganë.

<sup>(6)</sup> Shihni Organizata e Ushqimit dhe Agrikulturës e Kombeve të Bashkuara, Sistemi i analizës së rrezikut dhe pikës kritike të kontrollit (HACCP), (<http://www.fao.org/docrep/005/y1579e/y1579e03.htm>).

**Praktika e mirë në lidhje me ofrimin e ushqimit**

Konsiderohet praktikë e mirë:

- lejimi i aplikuesve të gatujnë vetë atëherë kur të jetë e mundur dhe e përshtatshme, me kusht që kjo të nxisë autonominë e tyre, rrit ndjesinë e normalitetit/ndjesisë së shtëpisë dhe mund të kontribuojë për strukturimin e jetës së përditshme të aplikuesve; dhe
- dhënia e mundësisë së aplikuesve që t'u serviren vakte të ndara të gatuar ose të ringrohura, nëse kishin arsye të bindshme që munguan orët normale të vakteve; dhe
- konsultimi i aplikuesve në lidhje me menynë dhe gatimin e ushqimit.

**STANDARDI 22: Sigurohuni që aplikuesit të kenë qasje në ujë të pijshëm pa ndalim.**

**Treguesi 22.1:** Secilit aplikues i ofrohen minimalisht 2,5 litra ujë në ditë, ndërkohë që merren parasysh dhe nevoja fiziologjike personale dhe klima.

- **Shënime shtesë:** Më shumë hollësi rreth sasisë minimale ditore të ujit të pijshëm mund të gjeni te standardet e zhvilluara si pjesë e projektit Sfera (<sup>7</sup>).

**Treguesit alternativë:**

**Treguesi 22.2(a):** Infrastruktura e vendit të strehimit është e përshtatshme për ujë të pijshëm. **OSE**

**Treguesi 22.2(b):** Në mungesë të infrastrukturës së përshtatshme, uji i pijshëm shpërndahet.

- **Shënime shtesë:** Aplikuesit duhet të njoftohen në lidhje me sigurinë e ujit të çezmës si ujë i pijshëm, aty ku zbatohet.

**Praktika e mirë në lidhje me ofrimin e pijeve**

Konsiderohet praktikë e mirë ofrimi i çajit dhe kafesë.

(<sup>7</sup>) Projekti Sfera, *Sa ujë nevojitet në emergjencë?*, gjendet në internet në adresën: [http://www.who.int/water\\_sanitation\\_health/publications/2011/WHO\\_TN\\_09\\_How\\_much\\_water\\_is\\_needed.pdf?ua=1](http://www.who.int/water_sanitation_health/publications/2011/WHO_TN_09_How_much_water_is_needed.pdf?ua=1)

## 3. Veshjet dhe artikujt e tjerë joushqimorë

### Shënime hyrëse

Në përputhje me seksionet rreth strehimit dhe ushqimit, standardet e përfshira në këtë seksion duhet të merren në konsideratë, pavarësisht nëse aplikuesve u ofrohen veshje në natyrë ose në formën e ndihmave financiare ose kuponëve. Kjo do të thotë se Shtetet Anëtare që zgjedhin t'u ofrojnë aplikuesve ndihmë financiare për të mbuluar kostot e veshjeve, kjo ndihmë duhet t'i lejojë aplikuesve që të blejnë veshje në përputhje me standardet e renditura në këtë seksion. Kjo vlen pa shpërfillur situatat kur aplikuesit zotërojnë që më parë veshje të mjaftueshme, në përputhje me standardet e përfshira në këtë seksion dhe si rrjedhojë nuk kanë nevojë të marrin veshje të tjera. Termi “veshje”, siç quhet në këtë seksion, i referohet veshjeve dhe këpucëve.

Në kontekstin e këtij udhëzuesi, termi “artikuj joushqimorë” i referohet artikujve thelbësorë shtëpiakë, që nuk janë ushqime, duke përfshirë për shembull produkte higjienë personale, produkte pastrimi dhe larjeje rrobash, çarçafë dhe peshqirë. Në kontekstin e aplikuesve të moshës shkollore, artikujt joushqimorë përfshijnë gjithashtu mjetet shkollore.

Ofrimi i artikujve joushqimorë duhet të kryhet gjithmonë duke marrë në konsideratë situatën familjare të aplikuesit. Në mënyrë specifike, përbërja e artikujve joushqimorë dhe sasia që ofrohet duhet të marrë parasysh nevojat personale të aplikuesit në fjalë.

#### Referencat ligjore — veshja dhe artikujt e tjerë joushqimorë

- Neni 2(g) RCD: përkufizimi i kushteve materiale të pranimit

### Standardet dhe treguesit

#### STANDARDI 23: Sigurohuni që aplikuesi të ketë veshje të mjaftueshme.

**Treguesi 23.1:** Aplikuesi ka veshje të brendshme të mjaftueshme për një javë, pa pasur nevojë të lajë rroba.

- **Shënime shtesë:** Sasia e mësipërme duhet të konsiderohet të jetë minimalisht tetë palë veshje të brendshme.

**Treguesi 23.2:** Aplikuesi ka të paktën një numër minimal artikujsh veshjeje.

- **Shënime shtesë:** Sasia e mësipërme duhet të konsiderohet të jetë të paktën pesë artikuj veshjeje të sipërme (si p.sh. bluzë me mëngë të shkurtra, këmbishë, bluzë), të paktën tre artikuj veshjeje të poshtme (pantallona, fund, pantallona të shkurtra), të paktën tre artikuj të tillë si bluzë me kapuç, triko ose xhakëtë dhe dy komplete veshjeje gjumi.

**Treguesi 23.3:** Aplikuesi ka të paktën dy palë të ndryshme këpucësh.

- **Shënime shtesë:** Kjo mund të përfshijë një palë këpucë për përdorim në shtëpi dhe një palë për përdorim jashtë.

**Treguesi 23.4:** Aplikuesve u ofrohen veshje sa më shpejt që të jetë e mundur.

- **Shënime shtesë:** Brenda pak orësh nga caktimi në një ambient strehimi, secili aplikues duhet të vishet me të paktën veshjen bazë (provizore), që t'u mundësojë atyre të lëvizin lirshëm në të gjitha zonat e qasshme (si brenda, dhe jashtë) të përcaktuara për ata.

**Treguesi 23.5:** Nëse ndonjë veshje nuk përdoret më si rezultat i konsumimit dhe grisjes, ka një mënyrë të standardizuar për ta shkëmbyer me një artikull tjetër.

**Treguesi 23.6:** Aplikuesit kanë veshje të mjaftueshme për bebet dhe fëmijët e vegjël për 1 javë, pa pasur nevojë të lajnë rrobat.

#### Praktika e mirë në lidhje me ofrimin e veshjeve të mjaftueshme

Konsiderohet praktikë e mirë:

- shmangia e krijimit të një “pamjeje uniforme” për të gjithë aplikuesit (nëse veshjet ofrohen në natyrë), sepse kjo ndihmon shmangien e stigmatizimit;
- caktimi i një “magazine donacionesh” dhe lidhja me OJQ-të humanitare për qëllimin e marrjes dhe shpërndarjes së veshjeve të përdorura.

### STANDARDI 24: Sigurohuni që aplikuesit të ketë veshje të përshtatshme.

**Treguesi 24.1:** Veshjet u përshtaten mjaftueshëm aplikuesve për sa i përket madhësisë.

**Treguesi 24.2:** Veshjet janë mjaftueshëm të paraqitshme dhe të përshtatshme me standardin e përgjithshëm të shoqërisë pritëse dhe me prejardhjen kulturore të aplikuesve.

- **Shënime shtesë:** Artikujt e veshjeve (përveç veshjeve të brendshme) nuk duhet të jenë të reja, por duhet të jenë në gjendje të mirë.

**Treguesi 24.3:** Disponohen veshje sezonale të përshtatshme.

- **Shënime shtesë:** Kjo do të thotë, për shembull, që aty ku nevojitet, aplikuesi duhet të ketë një pallto/xhakëtë dimri, doreza, kapuç dimri, kapele, shall dimri dhe këpucë dimri.

#### Praktika e mirë në lidhje me ofrimin e veshjeve të përshtatshme

Konsiderohet praktikë e mirë ofrimi i aplikuesve femra të paktën një vello si pjesë e grupit të veshjeve që u ofrohen, nëse ato e kërkojnë.

### STANDARDI 25: Sigurohuni që aplikuesit të kenë qasje në produkte higjienë personale të mjaftueshme dhe të përshtatshme.

**Treguesi 25.1:** Ekziston një listë që specifikon llojin dhe sasinë e produkteve të higjienës personale që kanë të drejtë të marrin aplikuesit e një moshe dhe gjinie të caktuar.

- **Shënime shtesë:** Kjo listë i komunikohet qartësisht aplikuesve.

**Treguesi 25.2:** Produktet e domosdoshme të higjienës personale vihen në dispozicion të aplikuesit, ose nëpërmjet shpërndarjes në natyrë sipas numrit të personave, ose nëpërmjet dietës së shpenzimeve të përditshme.

- **Shënime shtesë:** Për të mbajtur pastërti personale, higjienë dhe për të parandaluar sëmundjet infektive, produktet bazë të higjienës duhet të vihen në dispozicion të përdoruesit. Për shembull, këto duhet të përfshijnë: furçë dhëmbësh, pastë dhëmbësh, letër higjienike, sapun, shampo, makinë rroje/shkumë rroje, peceta sanitare, pelena për bebet dhe produkte të tjera higjienë, të domosdoshme për kujdesin ndaj bebeve.

### STANDARDI 26: Sigurohuni që aplikuesit të kenë qasje në artikuj të tjerë thelbësorë joushqimorë

**Treguesi 26.1:** Ofrohen çarçafë dhe peshqirë të mjaftueshëm.

- **Shënime shtesë:** Nëse aplikuesi është përgjegjës për larjen e çarçafëve të tij/saj, ofrohen të paktën dy palë për të lejuar ndërrimin e tyre.

**Treguesi 26.2:** Disponohet pluhur larës nëse aplikuesit janë përgjegjës për larjen e rrobave të tyre.

**Treguesi 26.3:** Janë vendosur sistemime specifike për aplikuesit me nevoja të veçanta.

- **Shënime shtesë:** Për shembull, kjo nënkupton që një familje me një foshnje ka mundësi të përdorë një karrocë funksionale dhe një fëmijë më i rritur një oturak. Çdo fëmijë mund të përdorë lodrat që i përshtaten moshës së tij ose të saj dhe ato duhet të jenë në gjendje të mirë. Një personi me aftësi të kufizuara fizike ose që rikuperohet nga një lëndim ose trajtim mjekësor, mund t'i ofrohen paterica, karrige me rrota ose pajisje tjetër mjekësore, nëse këto nuk mund të merren në vend tjetër (nga agjentë të tjerë, si p.sh. sistemi i shëndetit publik).

#### Praktika e mirë në lidhje me ofrimin e qasjes në artikuj të tjerë thelbësorë joushqimorë

Konsiderohet praktikë e mirë t'u ofrohet aplikuesve qasje në një komplet hekurosjeje dhe tharëse flokësh aty ku nevojitet.

**STANDARDI 27: Sigurohuni që fëmijëve të regjistruar në shkollë t'u ofrohen veshje të përshtatshme dhe aksesorë shkolle, që t'i ndihmojnë ata të marrin pjesë plotësisht në aktivitetet edukative të shkollës.**

**Treguesi 27.1:** Fëmijëve që ndjekin arsimin e detyrueshëm në shkollë u ofrohen veshje të përshtatshme për aktivitetet shkollore.

- **Shënime shtesë:** Kjo mund të përfshijë uniformë shkolle aty ku nevojitet, si dhe veshje dhe këpucë sportive.

**Treguesi 27.2:** Fëmijët që ndjekin shkollën marrin falas një çantë shkolle (çantë shpine ose tjetër) dhe të gjitha artikujt (librat e shkollës etj.) që kërkohen nga shkolla.





## 4. Dieta për shpenzimet ditore

### Shënime hyrëse

Meqenëse aspektet e ushqimit, strehimit dhe veshjes përcaktohen qartë në RCD, instrumenti nuk trajton në mënyrë të drejtpërdrejtë hollësitë dhe qëllimin e dietës për shpenzimet ditore. Megjithatë, koncepti është thelbësor për t’u përgjigjur nevojave të aplikuesve.

Dieta për shpenzimet ditore mbulon nevojat e tjera thelbësore të aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, të trajtuara nga RCD, të cilat shkojnë përtej strehimit, ushqimit dhe veshjes (ato që mbulohen nëpërmjet ndihmës financiar, kur nuk ofrohen në natyrë ose në formën e kuponëve).

Në këtë dokument, koncepti i “dietës për shpenzimet ditore” mund të kuptohet sikur ka tre qëllime të ndryshme, përkatësisht:

- t’u lejohet aplikuesve që të arrijnë një nivel minimal mbështetjeje fizike, përtej nevojave bazë për strehim, ushqim ose veshje;
- të garantojnë një standard minimal pjesëmarrjeje të aplikuesve në jetën social-kulturore të Shtetit Anëtar ku banojnë;
- t’u mundësojë aplikuesve që të shijojnë një shkallë autonomie.

Ky udhëzues i referohet “dietës për shpenzimet ditore” si minimale, si dietë monetare që i ofrohet aplikuesit, pa ndonjë qëllim të caktuar dhe që t’i ketë në dispozicion (“para xhepi”). Përveç kësaj, aty ku artikujt specifikë joushqimorë ose nevojat e tjera plotësuese nuk ofrohen në natyrë ose në formën e kuponëve, mund të merren parasysh edhe kostot e tyre kur llogaritet shuma e dietës për shpenzimet ditore, e cila u ofrohet aplikuesve.

Siç shihet në seksionet e mëparshme, standardet në lidhje me strehimin, ushqimin dhe veshjen, si dhe me disa artikuj të tjerë joushqimorë, mund të arrihet pavarësisht nëse aplikuesit i marrin artikujt përkatës si ndihmë financiare, në natyrë ose në formën e kuponëve. Njëkohësisht, elementi i fundit (“paratë e xhepit”) bazohen në konsideratën se një standard i respektueshëm jetese mund të arrihet vetëm kur aplikuesit kanë një nivel të caktuar autonomie financiare. Me fjalë të tjera, të paktën një pjesë e dietës që u jepet atyre nuk duhet të caktohet për një qëllim specifik, por të jetë në dispozicion të lirë të aplikuesve, për t’i lejuar ata që ta përdorin në përputhje me nevojat dhe preferencat e tyre personale.

Nga pikëpamja e ndryshimit të standardeve dhe kostove të jetesës në Shtetet Anëtare, ky seksion nuk përpiqet që të përcaktojë nivelin e saktë të dietës për shpenzimet ditore që do t’u ofrohet aplikuesve. Pavarësisht metodës që përdoret për llogaritjen e dietës për shpenzimet ditore, tre qëllimet e renditura më lart duhet të arrihen gjithmonë. Si rrjedhojë, shpenzimet ditore nuk duhet të keqkuptohen si akt bujarie; por kanë të njëjtën rëndësi si dhe strehimi, ushqimi dhe veshjet dhe formon një pjesë thelbësore të kushteve materiale të pranimit.

#### Referencat ligjore — dieta për shpenzimet ditore

- Neni 2(g) RCD: përkufizimi i kushteve materiale të pranimit

### Standardet dhe treguesit

#### STANDARDI 28: Sigurohuni që të ofrohet një dietë e përshtatshme për shpenzimet ditore.

**Treguesi 28.1:** Ekziston një përkufizim i qartë i objektivit të dietës për shpenzimet ditore.

**Treguesi 28.2:** Metoda e qarkullimit të dietës për shpenzimet ditore është përcaktuar qartë.

- **Shënime shtesë:** “Përcaktuar” nënkupton që përshkruhen elementet e marra parasysh kur është përcaktuar shuma e dietës për shpenzimet ditore dhe faktorët e marrë parasysh kur vlerësohet shuma në secilën prej tyre.

**Treguesi 28.3:** Dieta për shpenzimet ditore ofrohet në dispozicion të plotë (“para xhepi”) dhe i lejon aplikuesit të fitojnë një shkallë të përshtatshme autonomie.

- **Shënime shtesë:** Dieta për shpenzimet ditore “me dispozicion të plotë” nuk mund të ofrohet kurrë në natyrë. Shuma aktuale duhet të përcaktohet në lidhje me kontekstin kombëtar. Kjo duhet të marrë parasysh nevojat plotësuese përtej nevojave bazë, si p.sh. produktet ose shërbimet me zgjedhje individuale (p.sh. aktivitete kulturore, ëmbëlsira, produkte duhani, lojëra, dalje).

**Treguesi 28.4:** Shuma e dietës për shpenzime ditore reflekton gjithashtu minimalisht shpenzimet e mëposhtme, përveç rastit kur sigurohen në natyrë: komunikimin dhe informacionin, artikujt shkollorë, higjienën personale dhe kujdesin për trupin, aktivitetet e kohës së lirë dhe kostot për transportin kur bëhet fjalë për qasjen në kujdesin shëndetësor dhe përfitimin e mjekimeve, procedurën e azilit dhe ndihmën ligjore dhe arsimimin për fëmijët e regjistruar në shkollë.

- **Shënime shtesë:** Në lidhje me ofrimin në natyrë të artikujve shkollorë dhe higjienës personale dhe kujdesit për trupin, shihni standardet 25 dhe 26: Qasja në produktet e higjienës dhe artikujt joushqimorë dhe standardi 29: Qasja në kujdesin e nevojshëm shëndetësor.

**Treguesi 28.5:** Dieta për shpenzimet ditore ofrohet rregullisht dhe jo më pak se një herë në muaj për sa i përket “parave të xhepit”.

- **Shënime shtesë:** Rregullsia e ofrimit duhet të përcaktohet sipas qëllimit (nëse specifikohet), shumës dhe formës së zgjedhur për ofrimin e dietës. Duhet të garantohet gjithmonë transparencë.

#### Praktika e mirë në ofrimin e dietës për shpenzimet ditore

Konsiderohet praktikë e mirë:

- marrja parasysh e situatës individuale të aplikuesit (p.sh. moshë/përbërja familjare) kur llogaritet shuma e ofruar e dietës për shpenzimet ditore;
- ofrimi i dietës për shpenzimet ditore përpara periudhës në të cilën do ofroheshin;
- ofrimi i dietës veçmas për secilin anëtar të rritur të familjes (dhe jo “kryefamiljarit” për të gjithë familjen).

## 5. Kujdesi shëndetësor

### Shënime hyrëse

Termi “kujdes shëndetësor”, siç quhet në këtë seksion, përmbledh kujdesin shëndetësor mendor dhe fizik, i cili u ofrohet aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare. Ai përfshin gjithashtu këshillimin e aplikuesit që vuan nga sëmundje të rënda dhe masat e domosdoshme për të nxitur rehabilitimin e viktimave të dhunës dhe torturës. Në këtë kuptim, ekzaminimet mjekësore që kryhen nga disa Shtete Anëtare në fillim të procesit të pranimit, mund të ofrojnë një pikë të rëndësishme nisjeje, sepse mundëson një ide më të qartë të nevojave mjekësore të aplikuesve që duhet të trajtohen nëpërmjet procesit të pranimit. “Personeli mjekësor” për qëllimet e këtij seksioni quhen mjekët profesionistë të kualifikuar (p.sh. doktorët, dentistët, infermierët), si dhe psikologët.

Udhëzuesi duhet të lexohet në përputhje me parimet gjithëpërfshirëse të miratimit dhe konfidencialitetit, të cilat zbatohen për të gjithë personelin e pranimit dhe personelin mjekësor që përfshihet në ofrimin e kujdesit shëndetësor, si dhe për përkthyesit. Informacioni nuk duhet të ndahet në asnjë etapë pa miratimin paraprak të pacientit. Pa shpërfillur rregulloret kombëtare që diktojnë qasjen në regjistrat mjekësorë, aplikuesit duhet të kenë të drejtën të qasjen në regjistrat e tyre mjekësorë kur u nevojitet.

#### Referencat ligjore — Kujdesi shëndetësor

- Neni 13 RCD: ekzaminimi mjekësor
- Neni 17 RCD: rregullat e përgjithshme për kushtet materiale të pranimit dhe kujdesit shëndetësor
- Neni 19 RCD: kujdesi shëndetësor

### Standardet dhe treguesit

#### **STANDARDI 29: Garantoni qasjen në kujdesin e nevojshëm shëndetësor, të paktën në nivel emergjence dhe trajtim thelbësor të sëmundjeve dhe çrregullimeve të rënda mjekësore.**

**Treguesi 29.1:** Aplikuesi ka qasje në të gjitha llojet e shërbimeve të nevojshme të kujdesit shëndetësor.

- **Shënime shtesë:** *Aty ku mundet, duhet të merret në konsideratë gjinia kur ofrohet kujdes shëndetësor (p.sh. qasja te personeli mjekësor femëror kur kërkohet dhe është i disponueshëm).*

**Treguesi 29.2:** Shërbimet e kujdesit shëndetësor ofrohen nga personel mjekësor i kualifikuar.

**Treguesi 29.3:** Kujdesi mjekësor disponohet brenda vendit të strehimit ose jashtë në një distancë të arsyeshme.

- **Shënime shtesë:** *Për më shumë qartësime rreth “distançës së arsyeshme”, shihni standardin 1: Vendndodhja.*

**Treguesi 29.4:** Kujdesi i domosdoshëm shëndetësor, përfshi mjekimin e përshkruar, ofrohet falas ose kompensohet ekonomikisht nëpërmjet dietës për shpenzime ditore.

- **Shënime shtesë:** *Kjo do të thotë që edhe transporti për t’u qasur me kujdesin e domosdoshëm shëndetësor, ashtu dhe ofrimi i mjekimeve janë falas (shihni standardin 1: Vendndodhja, standardin 28: Ofrimi i një diete për shpenzimet ditore)*

**Treguesi 29.5:** Janë vendosur plane të përshtatshme për t’u siguruar që aplikuesi mund të komunikojë me personelin mjekësor.

- **Shënime shtesë:** *Në veçanti, kjo do të thotë që ofrohet një përkthyes i trajnuar (falas) atëherë kur është e nevojshme. Nëse aplikuesi pranon, edhe individët e tjerë mund të përkthejnë, përveç fëmijëve.*

**Treguesi 29.6:** Bëhen plane për të siguruar qasje në ndihmën e shpejtë në raste emergjente.

- **Shënime shtesë:** *Kompleti i ndihmës së shpejtë duhet të jetë i arritshëm.*

**Treguesi 29.7:** Aplikuesit i ofrohet qasje në regjistrat e tij/saj mjekësorë, pa shpërfillur legjislacionin kombëtar.

- **Shënime shtesë:** Nëse aplikuesi ka dhënë miratimin e tij/saj, regjistri mjekësor mund të transferohet nga njëri mjek tek tjetri.

**Treguesi 29.8:** Janë vendosur plane specifike për aplikuesit me nevoja të veçanta mjekësore.

- **Shënime shtesë:** Kjo do të përfshijë, për shembull, qasjen te një pediatër, gjinekolog ose kujdes shëndetësor përpara lindjes, ose do të sigurojë që personave me aftësi të kufizuara t'u ofrohen planet e domosdoshme. Kjo do të përfshinte gjithashtu këshillimin që ofrohet për viktimat e trafikut dhe dhunës (me bazë gjinore), si dhe për viktimat e torturës ose formave të tjera të dhunës psikologjike dhe fizike.

#### Praktika e mirë në lidhje me kujdesin shëndetësor

Konsiderohet praktikë e mirë:

- pajisja e ambienteve të përbashkëta të strehimit me të paktën një anëtar stafi të trajnuar për të dhënë ndihmën e shpejtë; dhe
- aty ku kujdesi shëndetësor parandalues dhe/ose vaksinimi nuk janë pjesë e programeve të përgjithshme të detyrueshme të shëndetit, të ofrojë kujdes shëndetësor parandalues, përfshi një ekzaminim mjekësor në pranim dhe/ose vaksinime; dhe
- ofrimi i profilaktikëve, si dhe disa ilaçeve falas, edhe kur nuk përshkruhen.

## 6. Ofrimi i informacionit dhe këshillimi

### Shënime hyrëse

“Ofrimi i informacionit”, siç quhet në këtë dokument, i referohet informacionit vetëm në kuadër të RCD-së. Pa shpërfillur informacionin që do t’u ofrohet aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, sipas instrumenteve të tjera të ngjashme, si Direktiva e rivendosjes 2013/32/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 26 qershor 2013 rreth procedurave të zakonshme për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare (që këtej e tutje: DP) dhe Rregullorja (e BE-së) nr. 604/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 qershor 2013, e cila përcakton kriteret dhe mekanizmat e përcaktimit të Shtetit Anëtar përgjegjës për ekzaminimin e një aplikimi për mbrojtje ndërkombëtare, të depozituar në një prej Shteteve Anëtare nga një shtetas i një shteti të tretë ose nga një person pa shtetësi (që këtej e tutje: Rregullorja III e Dublinit), ky udhëzues nuk përfshin standardet në lidhje me informacionin për procedurën e azilit. Megjithatë, vërehet se në disa Shtete Anëtare, ofrimi i këtij informacioni mund të jetë përgjegjësi e autoriteteve të pranimit.

Për të shmangur mbingarkimin e aplikuesit me informacion të tepërt gjatë pranimit, ofrimi i informacionit duhet të ndodhë me kalimin e kohës ose në faza specifike. Shtetet Anëtare inkurajohen që të vendosin periudha kohore që përshkruajnë llojin e informacionit që do t’u ofrohet aplikuesve në nivel kombëtar, ndërkohë që marrin parasysh maksimumin e përgjithshëm prej 15 ditësh që përshkruhet në Nenin 5 RCD.

Në lidhje me detyrën e Shtetit Anëtar për të garantuar mbështetjen e aplikuesit dhe për të mbrojtur, jo vetëm shëndetin fizik, por edhe atë mendor, siç është përcaktuar në Nenin 17(2), për aplikuesit duhet të disponohen masa mbështetëse, si p.sh. këshillimi social. Kjo mund të krijojë shumë lloje të ndryshme ndihme, duke filluar nga orientimi i aplikuesve se si të qasen te shërbimet publike, negocimi dhe orientimi kulturor dhe zgjidhja e konfliktit, si dhe udhëzimet sesi të trajtohen situatat specifike dhe hapat e tjerë në jetë. Për më tepër, këshillimi mund të lehtësojë gjithashtu identifikimin e aplikuesve me nevoja të veçanta (shihni seksionin 7: Identifikimi, vlerësimi dhe reagimi ndaj nevojave të veçanta).

#### Referencat ligjore — ofrimi i informacionit dhe këshillimi

- Neni 5 RCD: informacioni
- Neni 17(1) dhe (2): rregullat e përgjithshme për kushtet materiale të pranimit dhe kujdesit shëndetësor

### Standardet dhe treguesit

#### **STANDARDI 30: Sigurohuni që aplikuesi të marrë dhe të kuptojë informacionin që lidhet me fazën, për përfitimet dhe detyrimet në lidhje me kushtet e pranimit.**

**Treguesi 30.1:** Informacioni i shkruar ofrohet në një gjuhë që aplikuesi e kupton ose që supozohet në mënyrë të arsyeshme që e kupton.

- **Shënime shtesë:** Informacioni duhet të ofrohet të gjuhë të qartë dhe jo teknike.

**Treguesi 30.2:** Aty ku nevojitet dhe është e përshtatshme, informacioni ofrohet edhe verbalisht, në një gjuhë që aplikuesi e kupton.

- **Shënime shtesë:** Informacioni duhet të ofrohet të paktën verbalisht në rast analfabetizmi ose në rastet kur personi nuk e kupton informacionin e shkruar që është ofruar.

**Treguesi 30.3:** Informacioni mbulon të gjitha aspektet e kushteve të pranimit, përfshirë përfitimet dhe detyrimet sipas RCD-së.

- **Shënime shtesë:** Informacioni duhet të përfshijë minimalisht, të drejtën e pranimit, në varësi të statusit ligjor, formën e ofrimit të kushteve materiale të pranimit (strehim, ushqim, veshje dhe dieta për shpenzimet ditore), qasje në kujdesin shëndetësor dhe plane specifike për aplikuesit me nevoja të veçanta, nëse është e përshtatshme. Rregullat e shtëpisë duhet t’i komunikohen qartë aplikuesit. Informacioni mund të përfshijë gjithashtu disponueshmërinë e mbështetjes psikosociale shtesë, informacionin rreth normave shoqërore në Shtetin Anëtar, këshilla rreth jetës së përditshme, përfshirë menaxhimin e konflikteve etj.

**Treguesi 30.4:** Informacioni ofrohet në kohë (maksimumi në 15 ditë) pas paraqitjes së një aplikacioni për mbrojtje ndërkombëtare.

**Treguesi 30.5:** Informacioni ofrohet sipas nevojave të veçanta dhe rrethanave individuale të aplikuesve.

- **Shënime shtesë:** Për fëmijët, informacioni ofrohet në mënyrë të pranueshme për fëmijët (p.sh. nëpërmjet figurave, përdorimit të fjalëve të përshtatshme për fëmijët etj.). Për personat me vështirësi shikimi ose paaftësi intelektuale, informacioni ofrohet në një mënyrë të përshtatur. Ofrimi i informacionit përfshin aspekte që lidhen me dhunën me bazë gjinore ose trafikun e qenieve njerëzore.

#### Praktika e mirë në lidhje me ofrimin e informacionit

Konsiderohet praktikë e mirë:

- ofrimi i informacionit për aplikuesin në formë të shkruar dhe verbale, për shembull me ndihmën e përkthyesve ose negociatorëve kulturorë;
- sigurimi i shikueshmërisë së informacionit nëpërmjet përdorimit të videove ose figurave;
- verifikimi që aplikuesi e ka kuptuar informacionin e ofruar;
- ofrimi i informacionit në mënyrë specifike për fazën:
  - ✓ dita e mbërritjes: ofrimi i informacionit bazë rreth funksioneve të vendit të strehimit dhe të drejtës së pranimin dhe përfitimeve përkatëse, përfshi disponueshmërinë e punëtorit social (ose personeli tjetër që lidhet me procedurën e marrjes);
  - ✓ idealisht brenda 3 ditësh, jo më gjatë se 15 ditësh: ofrimi i informacionit shtesë rreth funksionimit të vendit të strehimit, jetës së përditshme, aktiviteteve, shkollës dhe kurseve. Ofrimi i rregullave të shtëpisë me shkrim, përfshi detyrimet e aplikuesit me aplikuesit e tjerë (si p.sh. të drejtat e femrave, respekti për diversitetin seksual dhe të drejtat e LGBTI-së) dhe ato që lidhen me kushtet e pranimin me të cilat duhet të pajtohen aplikuesit;
  - ✓ gjatë pritjes: ofrimi i informacionit shtesë rreth të drejtës së pranimin dhe në varësi të lidhjes me të: të drejtën e qëndrimit, kthimin vullnetar, të drejtën për të punuar, aspektet e nevojshme në lidhje me administratën, mirëqenien fizike dhe psikologjike, të drejtat dhe detyrimet kur jetoni në shoqërinë e Shtetit Anëtar, kurset dhe aktivitetet e disponueshme, rritjen e ndërgjegjësimit në aspektet si p.sh. higjiena personale, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, menaxhimin e konfliktit, ndarjen e mbeturinave, pastrimin, konsumimin e energjisë etj.;
  - ✓ në fund: informacioni i nevojshëm për përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare dhe ata të cilëve u janë refuzuar aplikacionet (strehimi, qasja te ndihma mjekësore etj.).

### **STANDARDI 31: Sigurohuni që ofrimi i informacionit ose organizatave ose grupeve të personave që ofrojnë ndihmë të posaçme ligjore dhe organizatave që mund t'ju ndihmojmë ose të njoftojnë aplikuesit rreth kushteve të disponueshme të pranimin, përfshirë kujdesin shëndetësor.**

**Treguesi 31.1:** Për aplikuesit ofrohet informacion rreth ndihmës ligjore të disponueshme dhe mënyrës se si mund të qasen.

**Treguesi 31.2:** Informacioni që u ofrohet aplikuesve përfshin të dhënat e kontaktit të organizatave ose grupeve të personave që mund t'i njoftojnë aplikuesit rreth kushteve të pritjes që disponohen, përfshirë kujdesin shëndetësor dhe se si t'i qasen.

**Treguesi 31.3:** Informacioni i shkruar ofrohet në një gjuhë që aplikuesi e kupton ose që supozohet në mënyrë të arsyeshme që e kupton.

- **Shënime shtesë:** Informacioni duhet të ofrohet të gjuhë të qartë dhe jo teknike.

**Treguesi 31.4:** Aty ku nevojitet dhe është e përshtatshme, informacioni ofrohet edhe verbalisht, në një gjuhë që aplikuesi e kupton.

- **Shënim shtesë:** Informacioni duhet të ofrohet të paktën verbalisht në rast analfabetizmi ose në rastet kur personi nuk e kupton informacionin e shkruar që është ofruar.

**Treguesi 31.5:** Informacioni duhet të ofrohet në kohë (maksimumi në 15 ditë) pas paraqitjes së një aplikacioni për mbrojtje ndërkombëtare.

**Treguesi 31.6:** Informacioni ofrohet sipas nevojave të veçanta dhe rrethanave personale të aplikuesve.

- **Shënime shtesë:** Për shembull, informacioni që synon fëmijët ofrohet në mënyrë të përshtatshme për fëmijët (p.sh. në mënyrë grafike, duke përdorur figura). Informacioni tjetër që ofrohet mund të përfshijë aspekte që lidhen me dhunën me bazë gjinore ose trafikun e qenieve njerëzore.

**STANDARDI 32: Garantoni qasjen e përshtatshme për këshilluesit ose konsulentët ligjorë, personat që përfaqësojnë UNHCR-në, Kryqin e Kuq, organizatat përkatëse ndërqeveritare dhe joqeveritare që njihen nga Shteti Anëtar në fjalë, në mënyrë që të ndihmoni aplikuesit.**

**Treguesi 32.1:** Qasja e aktorëve të mësipërm kufizohet vetëm mbi arsyet që lidhen me sigurinë e ambienteve dhe të aplikuesve, me kusht që të mos jetë tejet i kufizuar ose të bëhet i pamundur.

**Treguesi 32.2:** Aktorët e renditur më lart mund të takohen dhe të flasin me aplikuesit në kushte që sigurojnë privatësinë e duhur.

**STANDARDI 33: Siguroni qasje në këshillimin social për aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare.**

**Treguesi 33.1:** Këshillimi social disponohet për aplikuesit brenda ose jashtë ambientit të strehimit.

**Treguesi 33.2:** Aplikuesit mund të kenë qasje në këshillimin social rregullisht dhe sipas nevojave të tyre personale.

- **Shënime shtesë:** Qasja në këshillimin social mund të marrë formën e një interviste personale ose nëpërmjet telefonit.





## 7. Identifikimi, vlerësimi dhe reagimi ndaj nevojave të veçanta

### Shënime hyrëse

Aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare janë zakonisht në një situatë delikate, duke marrë parasysh pasigurinë e statusit të tyre në një vend të huaj dhe shpesh përvojat e tyre në vendin e origjinës dhe/ose gjatë udhëtimit. Si rrjedhojë, siç tregohet në figurën 1 në hyrje të këtij dokumenti, nevojat e veçanta ndërhyjnë tek ofrimi i kushteve të pranimit, sepse disa aplikues do të kërkojnë ndihmë të veçantë të mëtejshme, e cila lidhet me një nga seksionet që përfshihet në këtë udhëzues për t'i mundësuar ata të përfitojnë nga trajtimi i barabartë për të drejtat dhe përfitimet nga RCD-ja.

Oficerët e pranimit, në kontakt me aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare dhe kushdo që përfshihet në të gjithë procesin, duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të mund të identifikojnë nevojat e veçanta. Treguesit dhe nevojat e veçanta duhet të regjistrohen sa më shpejtë që të jetë e mundur pasi të zbulohen dhe ky informacion duhet t'u komunikohet grupeve përkatëse të interesit, për të ofruar garancitë dhe mbështetjen e nevojshme.

Kapitulli IV i RCD-së specifikon garancitë për aplikuesit me nevoja të veçanta. Një listë joshtruese e personave që mund të kenë nevoja të veçanta pranimit përfshin: të miturit, të miturit e pashoqëruar, personat me aftësi të kufizuara, personat e moshuar, gratë shtatzëna, prindërit beqarë me fëmijë të mitur, viktimat e trafikut njerëzor, personat me sëmundje të rënda, personat me çrregullime mendore dhe personat që kanë kaluar tortura, përdhunim ose forma të tjera të rënda dhune psikologjike, fizike ose seksuale, si p.sh. viktimat e gjymtimit të organeve gjenitaleve femërore.

Përveç kësaj, Shtetet Anëtare kanë detyrimin të vlerësojnë, tregojnë dhe trajtojnë nevojat e veçanta të këtyre aplikuesve në kohë dhe të sigurohen që identifikimi i tyre të jetë i mundshëm edhe në fazat e mëvonshme, nëse dobësitë nuk shfaqen më herët.

Një aspekt i rëndësishëm është nevoja për t'u siguruar që mekanizmat e referimit në Shtetet Anëtare funksionojnë saktë për t'i komunikuar nevojat e veçanta në mënyrë efikase. Pa shpërfillur parimin e konfidencialitetit, autoritetet kombëtare duhet të jenë në gjendje dhe të udhëzohen për ta ndarë informacionin përkatës rreth nevojave të veçanta që identifikohen. Për shembull, aty ku oficerët që kanë kontaktin e parë, si p.sh. rojet e kufirit, kanë shënuar që një person ka nevoja të veçanta, ato duhet t'u komunikohen autoriteteve të pranimit, në mënyrë që të sigurohen sa më shpejt që të jetë e mundur garancitë e nevojshme. Në anën tjetër, oficerët e pranimit vendosen shpesh në pozicionin që t'i vëzhgojnë aplikuesit për një periudhë të gjatë kohe dhe të krijojnë besim. Kjo do t'u lejonte atyre të identifikonin me efikasitet nevojat e veçanta, të cilat fillimisht mund të mos jenë të dukshme. Derisa ky informacion ka të bëjë gjithashtu me nevoja të veçanta procedurale, është e rëndësishme që autoriteti i pranimit t'ia komunikojë këtë autoritetit përcaktues.

Ky seksion i udhëzuesit trajton detyrimin e Shteteve Anëtare për të identifikuar, vlerësuar dhe regjistruar dhe/ose komunikuar nevojat e veçanta të pranimit dhe për t'u përgjigjur atyre në kohë. Disa shembuj të garancive të pranimit të veçantë tregohen në seksione të ndryshme të këtij dokumenti. Për udhëzime më të plota dhe një mjet praktik për këtë, referojuni Mjetit të identifikimit të personave me nevoja të veçanta (IPSN) të EASO-s <sup>(8)</sup>.

#### Referencat ligjore — Identifikimi, vlerësimi dhe reagimi ndaj nevojave të veçanta

- Neni 21 RCD: parimi i përgjithshëm
- Neni 22 RCD: vlerësimi i nevojave të veçanta të pritjes
- Neni 23: të miturit
- Neni 24: të miturit e pashoqëruar
- Neni 25: viktimat e torturës dhe dhunës

<sup>(8)</sup> <http://ipsn.easo.europa.eu/>.

## Standardet dhe treguesit

### **STANDARDI 34: Sigurori që të caktohet një mekanizëm për të identifikuar dhe vlerësuar nevojat e veçanta të pranimi.**

**Treguesi 34.1:** Është caktuar një mekanizëm i standardizuar për të identifikuar dhe vlerësuar nevojat e veçanta të pranimi për çdo aplikues.

- **Shënim shtesë:** Siç specifikohet në Nenin 22(2) RCD, ky mekanizëm nuk ka nevojë të marrë formën e një procedure administrative por duhet t'i referohet mbrojtjes së fëmijës dhe standardeve për sigurinë e fëmijës. Vegla IPSN e EASO-s mund të integrohet te ky mekanizëm.

**Treguesi 34.2:** Mekanizmi përshkruan në qartësi se cili është përgjegjës për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të veçanta të pranimi.

- **Shënime shtesë:** Në varësi të sistemit kombëtar, në identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të veçanta mund të përfshihen aktorë të ndryshëm. Rolet e aktorëve të ndryshëm duhet të tregohen qartësisht në mekanizëm.

**Treguesi 34.3:** Mekanizmi përshkruan qartësisht se si regjistrohen dhe i komunikohen identifikimi dhe regjistrimi aplikuesit dhe aktorëve përkatës.

- **Shënime shtesë:** Regjistrimi dhe komunikimi efikas i informacionit në lidhje me nevojat e veçanta të aktorët përkatës është shumë i rëndësishëm për të siguruar që janë caktuar garancitë e nevojshme. Mbrojtja kombëtare e konfidencialitetit dhe të dhënave do të zbatohet gjatë përdorimit të mekanizmit. Në disa raste, do të zbatohen procedurat zyrtare, p.sh. në rastin e mekanizmave referues kombëtarë për viktimat e trafikut.

### **STANDARDI 35: Sigurohuni që mekanizmi për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të veçanta të pranimi të zbatohet me efikasitet.**

**Treguesi 35.1:** Për të identifikuar, vlerësuar dhe monitoruar nevojat e veçanta caktohen burime të mjaftueshme.

**Treguesi 35.2:** Identifikimi dhe vlerësimi fillestar i nevojave të veçanta kryhet sa më shpejt që është e mundur.

- **Shënime shtesë:** Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të veçanta të pranimi mund të kryhet në fazë të ndryshme. Rekomandohet që identifikimi dhe vlerësimi fillestar të kryhen gjatë hyrjes në pranim (1 deri në 3 ditë). Në varësi të nevojave të veçanta përkatëse, duhet të kryhen identifikime dhe/ose vlerësime të vazhdueshme shtesë.

**Treguesi 35.3:** Nevojat e veçanta, të cilat bëhen të dukshme në një etapë të mëvonshme, identifikohen dhe vlerësohen në mënyrë të përshtatshme.

- **Shënime shtesë:** Disa nevoja të veçanta pranimi mund të shfaqen vetëm në një periudhë të mëvonshme. Si rrjedhim, është e rëndësishme që identifikimi dhe vlerësimi të jenë të vazhdueshëm.

**Treguesi 35.4:** Aty ku është e përshtatshme, në vlerësimin e nevojave të veçanta përfshihen aktorë të specializuar.

- **Shënime shtesë:** Aktorët e specializuar, si p.sh. psikologët ose mjekët, mund të përfshihen në vlerësimin e nevojave të veçanta, në varësi të natyrës së këtyre nevojave. Ekspertiza e tyre duhet të qaset me efikasitet tek autoritetet e pranimi sa herë që nevojitet.

**Treguesi 35.5:** Kanalet e komunikimit dhe bashkëpunimi ndërmjet autoritetit të pranimi dhe autoritetit të përcaktimit janë vendosur dhe përdoren.

- **Shënime shtesë:** Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të veçanta është më efikas kur informacioni komunikohet ndërmjet autoriteteve, pa shpërfillur konfidencialitetin kombëtar dhe rregulloret për mbrojtjen e të dhënave.

**Treguesi 35.6:** Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të veçanta të pranimit kryhet pa shpërfillur ekzaminimin e nevojës së aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare.

- **Shënime shtesë:** Është e rëndësishme të ndahen qartësisht çështjet e identifikimit dhe vlerësimit të nevojave të veçanta të pranimit (dhe procedurale) dhe ekzaminimi i aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare. Ndërkohë që në disa raste situata e dobësisë së aplikuesve do të kishte ndikim edhe në rezultatin e aplikimit, qëllimi i identifikimit dhe vlerësimit, sipas këtij udhëzuesi është vetëm garantimi i qasjes efektive në të drejtat dhe përfitimet sipas RCD-së, gjatë procedurës së azilit.

### **STANDARDI 36: Sigurohuni që nevojat e veçanta të identifikuar të pritjes të trajtohen në kohë.**

**Treguesi 36.1:** Ndërmerren masa të përshtatshme dhe të menjëhershme për t'iu përgjigjur nevojave të veçanta të identifikuar dhe të vlerësuara.

- **Shënime shtesë:** Në përgjigje të nevojave të veçanta duhet të caktohen burime të mjaftueshme. Përveç kësaj, procedurat standarde të përdorimit dhe/ose mekanizmat e referimit duhet të përdoren sipas nevojës.

**Treguesi 36.2:** Nëse janë identifikuar nevojat e veçanta, ekziston një mekanizëm për të siguruar monitorimin e tyre të rregullt.

- **Shënime shtesë:** Shtetet Anëtare duhet të parashikojnë gjithashtu monitorimin e rregullt pasues të nevojave të veçanta të identifikuar.

#### **Praktika e mirë për identifikimin, vlerësimin dhe reagimin ndaj nevojave të veçanta**

Konsiderohet praktikë e mirë:

- vendosja e një mekanizmi për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të veçanta të pranimit, si pjesë e procedurave kombëtare të punës. Vegla IPSN e EASO-s mund të integrohet në këto procedura, veçanërisht duke zbatuar udhëzuesin rreth “Mbështetjes së pranimit”;
- konsiderimin si aplikues me nevoja të veçanta edhe kategori të ndryshme nga ato të renditura në mënyrë joshteruese në kapitullin IV të RCD-së, për shembull LGBTI, personat me nevoja të veçanta të tjera që lidhen me gjininë dhe aplikuesit analfabetë.

#### **Vegla e EASO-s për identifikimin e personave me nevoja të veçanta (IPSN)**

Për të mbështetur Shtetet Anëtare në identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të veçanta, për sa i përket garancive procedurale dhe të pranimit, EASO ka zhvilluar një vegël ndërvepruese të bazuar në internet, me qasje nga publiku në një sërë gjuhësh të BE-së.

Vegla IPSN është një instrument praktik intuitiv, i synuar për të mbështetur identifikimin në kohë dhe të vazhdueshëm të nevojave të veçanta të individit, pa kërkuar njohuri të specializuara. Ajo mbështetet në një sërë treguesish, të lidhur me kategori të ndryshme personash me nevoja të veçanta të mundshme. Lista përfshin të gjitha kategoritë e përmendura nga RCD-ja, si dhe personat LGBTI dhe personat me nevoja të veçanta që lidhen me gjininë. Zgjedhja e një kategorie ofron informacion të mëtejshëm për të vlerësuar nëse aplikuesi ka nevojat e veçanta përkatëse dhe krijon një listë dhe udhëzime të shkurtra për masat përkatëse të mbështetjes. Mbështetja për pranimin është një prej aspekteve të zhvilluara brenda veglës IPSN.

Pas krijimit të informacionit përkatës nga përdoruesi, ai ose ajo mund të zgjedhë që të printojë ose të ruajë një raport, përfshirë zgjedhjen e elementeve të ndryshme. Raporti mund të individualizohet më tej për rastin e posaçëm në fjalë, përpara se të ruhet dhe/ose printohet.

Rekomandohet si praktikë e mirë, integrimi i veglës IPSN në një mekanizëm kombëtar, i cili është në përputhje me standardet në këtë seksion.

Vegla disponohet në <https://ipsn.easo.europa.eu>



## 8. Trajnimi i stafit

### Shënime hyrëse

Për shkak të diversitetit të sistemit kombëtar të pranimit, detyrat, kualifikimet dhe nevojat për trajnim të stafit që punon me aplikuesit në kontekstin e pranimit, ndryshojnë ndërmjet Shteteve Anëtare të BE-së. Në lidhje me udhëzuesin që përfshihet në këtë seksion, do të merret referencë termi “oficeri i pranimit”, që mund të përkufizohet si profesionistët që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare në kontekstin e pranimit, pavarësisht punëdhënësit të tyre (shtetit, një organizate joqeveritare, një kontraktori privat, një bashkie etj.). Këta profesionistë mund të përfshijnë punëtorë socialë, edukatorë dhe personel të kujdesit shëndetësor, oficerë regjistrimi, përkthyes, menaxherë të ambienteve të pranimit, personel administrate/koordinimi etj. RCD-ja njih rëndësinë e trajnimit të përshtatshëm dhe të vazhdueshëm, si dhe lidhjen e mekanizmit për të monitoruar cilësinë e punës që kryhet nga oficerët e pranimit. Në mënyrë specifike, Shteteve Anëtare u kërkohet që të “marrin masat e duhura për t’u siguruar që autoritetet dhe organizatat e tjera që e zbatojnë këtë direktivë, të kenë marrë trajnimin bazë të nevojshëm”.

Në këtë kuadër, udhëzuesi që përfshihet në këtë seksion duhet të kuptohet sikur zbatohet për të gjitha nivelet e personelit (pra përfshi menaxhimin e mesëm dhe të lartë), që shtrihet brenda përkufizimit të termit “oficer pranimit”. Për më tepër, pa shpërfillur nevojën për të ofruar trajnim specifik për oficerët e pranimit që punojnë me aplikuesit me nevoja të veçanta pranimit, i gjithë trajnimi duhet të bashkërenditet me një kuadër më të gjerë të një kodi sjelljeje që specifikon konceptet dhe parimet kryesore që formojnë themelin e punës në kontekstin e pranimit.

#### Referencat ligjore — trajnimi i personelit

- Neni 18(7) RCD: modalitetet për kushtet e pranimit
- Neni 24(4) RCD: të miturit e pashoqëruar
- Neni 25(2) RCD: viktimat e torturës dhe dhunës
- Neni 29(1) RCD: personeli dhe burimet

### Standardet dhe treguesit

#### STANDARDI 37: Sigurohuni që oficerët e pranimit të jenë të kualifikuar mjaftueshëm.

**Treguesi 37.1:** Secili oficer pranimit ka terma reference të qarta (përshkrim pune).

**Treguesi 37.2:** Secili oficer pranimit është i kualifikuar në përputhje me ligjin dhe rregulloret kombëtare që lidhen me termat e tij/saj të veçantë të referencës (përshkrimin e punës).

- **Shënim shtesë:** *Procesi i vlerësimit të kualifikimeve të oficerit të pranimit duhet të përfshijë një verifikim të gjendjes penale, në lidhje me krime ose shkelje që lidhen me fëmijët, në rastet kur ky oficer pranimit do të punojë në kontakt të drejtpërdrejt me fëmijët.*

#### STANDARDI 38: Sigurohuni që oficerëve të pranimit t’u ofrohet trajnimi i nevojshëm dhe i përshtatshëm.

**Treguesi 38.1:** Secili oficer pranimit ka një pjesë hyrjeje të plotë dhe në kohë për rolin e tij/saj, përfshirë për kodin e sjelljes në fuqi.

- **Shënim shtesë:** *Trajnimi hyrës duhet të kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë sesa menjëherë pas punësimit të oficerit të pranimit. Në varësi të rolit që i caktohet oficerit të pranimit, trajnimi hyrës duhet të përfshijë standardet e ligjit dhe/ose rregulloret të pranimit në fuqi, veglave të disponueshme kombëtare dhe përkatëse të EASO-s.*

**Treguesi 38.2:** Ekziston një program i qartë trajnimi që përfshin kërkesat e trajnimit për çdo grup funksional.

- **Shënim shtesë:** *Trajnimi bazë për oficerët e pranimit mund të ofrohet nëpërmjet modulit të programit të trajnimit të EASO-s për pranimin. Përveç kësaj, modulet e përfshira në programin kombëtar mund të shtrihen nga aftësitë kompjuterike dhe gjuhët e huaja, deri te një kurs mbi sëmundjet infektive ose identifikimin e viktimave të trafikut njerëzor.*

**Treguesi 38.3:** Trajnimi ofrohet rregullisht dhe në varësi të nevojës.

- **Shënime shtesë:** Duhet të zhvillohet një program trajnimi afatgjatë, që parashikon trajnim freskues të rregullt. Trajnimi duhet të ofrohet nëse ka ndryshime thelbësore në ligjin dhe praktikën në fuqi.

**Treguesi 38.4:** Minimumi i trajnimit që ofrohet përfshin shqetësimet gjinore dhe specifike të moshës dhe situatën e aplikuesve me nevoja të veçanta, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve dhe sigurimin e standardeve për fëmijët, përfshirë fëmijët e pashoqëruar dhe identifikimin e viktimave të torturës dhe dhunës.

#### Praktika e mirë në lidhje me trajnimin e personelit

Konsiderohet praktikë e mirë për menaxherët e pranimit:

- identifikimi i mundësive të trajnimit për oficerët e pranimit; dhe/ose
- organizimi i trajnimit nëpërmjet marrëveshjeve me aktorët përkatës (universitetet, juristët, psikologët etj.).

### **STANDARDI 39: Promovoni ndërgjegjësimin e grupeve të tjera të interesit që janë në kontakt të rregullt me aplikuesit.**

**Treguesi 39.1:** Janë vendosur sesione të rregullta të rritjes së ndërgjegjësimin dhe/ose plane alternative për personat që nuk konsiderohen “oficerë pranimi”, por që sidoqoftë janë në kontakt me aplikuesit për shkak të profesionit/funksionit të tyre.

- **Shënime shtesë:** Sesionet e rritjes së ndërgjegjësimin mund të fokusohen në aspektet që lidhen me migrimin në përgjithësi dhe me aspektet kulturore në veçanti. Për shembull, këto mund të organizohen për personelin e edukimit, shërbimet e jashtme shëndetësore, personelin e sigurisë në ambiente ose personelin e pastrimit.

### **STANDARDI 40: Promovoni mbështetjen e procesit për oficerët e pranimit.**

**Treguesi 40.1:** Disponohen masa të ndryshme për të ndihmuar në trajtimin e situatave të vështira që hasen gjatë punës së pranimit.

- **Shënim shtesë:** këto masa mund të marrin formën e ndërkonceptimit (shkëmbimit me kolegët), ekipeve të krizës ose mbikëqyrjes së jashtme.

## Shtojcë — Tabela përmbledhëse

Standardet e punës dhe treguesit rreth kushteve të pranimit				
Seksioni	Nëseksioni	Standardi	Treguesi(t)	
1. Strehimi	1.1. Vendndodhja	1. Sigurimi i qasjes gjeografike në shërbimet përkatëse, si p.sh. shërbimet publike, shkolla, kujdes shëndetësor, ndihmë sociale dhe ligjore, dyqan për nevojat e përditshme, shërbim larjeje rrobash dhe veprimtari në kohën e lirë.	1.1. Janë vendosur sistemime specifike për aplikuesit me nevoja të veçanta.	
			1.2. (a) Me strehimin ofrohen shërbimet përkatëse. OSE	
			1.2. (b) Ambienti gjendet në një distancë të arsyeshme ecjeje në këmbë larg shërbimeve përkatëse dhe infrastruktura e disponueshme është e sigurt për ecje. OSE	
			1.2. (c) Shërbimet përkatëse qasen nëpërmjet transportit publik dhe kohëzgjatja e udhëtimit është e arsyeshme. OSE	
				1.2. (d) Shërbimet përkatëse qasen nëpërmjet transportit të organizuar, i cili ofrohet nga Shteti Anëtar.
	1.2. Caktimi	2. Sigurohuni që të respektohet parimi i unitetit familjar.	2.1. Anëtarët e familjes (në përputhje me përkufizimin e Nenit 2 RCD) akomodohen së bashku, sipas marrëveshjes.	
			2.2. Familjet me fëmijë akomodohen së bashku, me kusht që kjo të jetë në përputhje me interesat më të mira të fëmijës.	
			2.3. Aty ku mundet dhe është e pranueshme, uniteti familjar duhet të respektohet në lidhje me anëtarët e familjes më të gjerë.	
			2.4. Një dhomë gjumi caktohet për maksimumi një familje.	
		3. Sigurohuni që të merren parasysh nevojat e veçanta kur (ri)caktoni strehim të posaçëm për një aplikues.	3.1. Caktimi i strehimit të posaçëm për aplikuesit bazohet në vlerësimin e nevojave të tyre të veçanta të pranimit.	
	3.2. Si rezultat i nevojave të identifikuara të veçanta të pranimit, ekziston mundësia që një aplikues të transferohet.			
	4. Sigurohuni që arsyet specifike dhe objektive të lidhura me situatën individuale të aplikuesit të merren parasysh kur caktoni strehim për një aplikues	4.1. Është ngritur një mekanizëm për të gjykuar nëse ekzistojnë arsye specifike dhe objektive për caktimin e strehimit të posaçëm.		

Standardet e punës dhe treguesit rreth kushteve të pranimit			
Seksioni	Nëseksioni	Standardi	Treguesi(t)
1. Strehimi	1.3. Infrastruktura	5. Siguroni hapësirë të mjaftueshme në dhomë në strehimet e përbashkëta.	5.1. Për secilin aplikues ofrohet një hapësirë minimale prej 4 m <sup>2</sup> .
			5.2. Në lidhje me hapësirën minimale prej 4 m <sup>2</sup> për person, sigurohet një dhomë me lartësi minimale 2.10 m.
			5.3. Në dhomën e gjumit ka hapësirë të mjaftueshme për të vendosur një shtrat dhe një dollap për secilin aplikues.
		6. Siguroni respektimin e privatësisë së aplikuesve në strehimet e përbashkëta.	6.1. Në një dhomë gjumi akomodohen maksimumi gjashtë aplikues individualë.
			6.2. Për aplikuesit individualë meshkuj dhe femra ekzistojnë dhoma gjumi të ndara dhe nuk ka asnjë mundësi hyrjeje për aplikuesit e seksit tjetër.
			6.3. Parashikohet një dhomë që krijon një ambient privat (brenda ose jashtë godinës) për takimet me ndihmësin ligjor, punëtorin social ose aktorët e tjerë përkatës dhe kjo disponohet për aplikuesit kur nevojitet.
			6.4. Janë vendosur sistemime specifike për aplikuesit me nevoja të veçanta.
		7. Sigurohuni që vendi i strehimit të jetë mobiluar mjaftueshëm.	7.1. Mobilet për çdo dhomë gjumi individuale përfshijnë minimalisht:
			7.1.1. 1: një shtrat individual për person; DHE
			7.1.2. 1: një dollap për person ose familje, mjaftueshëm i madh për të mbajtur sendet personale (si p.sh. rrobat, ilaçet ose dokumentet).
			7.2. Në dhomat e gjumit të përbashkëta me aplikues të tjerë që nuk janë anëtarë familjeje, dollapi kyçet, pa shpërfillur çështjet e sigurisë së ambientit të pranimit.
			7.3. Mobilet në zonën e përbashkët/të banimit përfshijnë një numër të mjaftueshëm tavolinash dhe karrigesh.
			7.4. Në ambientet ku aplikuesve u kërkohet të gatujnë vetë, ofrohen dhe mundësohen si më poshtë:
			7.4.1. një hapësirë e mjaftueshme në frigorifer për person; DHE
			7.4.2. një hapësirë e mjaftueshme në raft për person/familje; DHE
7.4.3. një mundësi minimale për përdorimin e sobës për person/familje; DHE			
7.4.4. një numër minimal pjatash, enësh gatimi dhe lugësh e pirunësh për person.			
7.5. Disponohen sistemime specifike për aplikuesit me nevoja të veçanta.			



Standardet e punës dhe treguesit rreth kushteve të pranimit			
Seksioni	Nëseksioni	Standardi	Treguesi(t)
1. Strehimi	1.3. Infrastruktura	8. Siguroni infrastrukturë sanitare të mjaftueshme, të përshtatshme dhe funksionale në vendin e strehimit.	8.1. Të gjithë aplikuesit duhet të kenë qasje në dush/banjë, në një lavaman me ujë të ftohtë dhe të nxehtë dhe një tualet funksional.
			8.2. Të paktën një tualet funksional dhe që kyçet për 10 aplikues është i disponueshëm pa kufizime.
			8.3. Të paktën një dush ose banjë funksionale me ujë të nxehtë dhe të ftohtë ekziston për 12 aplikues dhe është e disponueshme minimalisht 8 orë në ditë.
			8.4. Të paktën një lavaman funksional me ujë të nxehtë dhe të ftohtë për 10 aplikues është i disponueshëm pa kufizime.
			8.5. Nëse në banjë gjenden më shumë se një dush, duhet të sigurohet ndarje e dukshme.
			8.6. Ekzistojnë ambiente tualeti, lavamanësh dhe dushesh, të ndara sipas seksit (të dukshme dhe me shenja të kuptueshme), përveç rastit të ambienteve të vogla të strehimit.
			8.7. Për sa i përket strehimit të përbashkët për aplikuesit që nuk janë anëtarë familjeje, janë kryer rregullime që të sigurohet se aplikuesit mund të hyjnë të sigurt te këto ambiente dhe që intimiteti i aplikuesve të respektohet gjatë gjithë kohës.
			8.8. Janë kryer rregullime për t'u siguruar që rrobat dhe peshqirët të qëndrojnë të thata ndërkohë që aplikuesit bëjnë dush.
			8.9. Janë vendosur sistemime specifike për aplikuesit me nevoja të veçanta.
		9. Siguroni pajtueshmërinë e vendit të strehimit me rregulloret përkatëse kombëtare dhe vendore.	9.1. Vendi i strehimit është ndërtuar në përputhje me rregulloret vendore dhe kombëtare në fuqi.
			9.2. Vendi i strehimit mirëmbahet dhe përdoret në përputhje me rregulloret përkatëse vendore dhe kombëtare, duke marrë parasysh të gjitha rreziqet e mundshme.
			9.3. Në dhomat e gjumit dhe zonat e përbashkëta/të ndenjjes në vendin e strehimit hyn dritë natyrale dhe ajër i pastër i mjaftueshëm.
			9.4. Për të gjitha zonat e shtëpisë ekziston një sistem i përshtatshëm i rregullimit të temperaturës.
			9.5. Dhomat e gjumit dhe zonat e përbashkëta mbrohen nga zhurma e lartë e ambientit.

Standardet e punës dhe treguesit rreth kushteve të pranimit			
Seksioni	Nëseksioni	Standardi	Treguesi(t)
1. Strehimi	1.3. Infrastruktura	10. Sigurohuni që infrastruktura e brendshme dhe e jashtme e vendit të strehimit që përcaktohet për të strehuar aplikuesit me mundësi të kufizuar lëvizjeje, t'i përshtatet nevojave të tyre.	10.1. Vendi i strehimit gjendet: (a) në katin përdhes; OSE (b) ekziston një ashensor i përshtatur për përdorim nga personat me mundësi të kufizuar lëvizjeje; OSE (c) numri i shkallëve nuk e kalon maksimumin, sipas nivelit të mundësisë së kufizuar të lëvizjes.
			10.2. Rrugët hyrëse të jashtme, si p.sh. rrugicat ose rruga e makinave kanë sipërfaqe të fortë dhe të rrafshët.
			10.3. Hyrja është ndërtuar për të lejuar hyrjen e aplikuesve me mundësi të kufizuar lëvizjeje.
			10.4. Dyert dhe korridoret brenda vendit të strehimit janë të gjera mjaftueshëm për përdoruesit e karrigeve me rrota.
			10.5. Hekurat mbajtës ekzistojnë për mbështetje në dhomat dhe vendet që përdoren nga aplikuesit me mundësi të kufizuar lëvizjeje.
			10.6. Infrastruktura e përshtatur sanitare ekziston, përfshirë për shembull, dushe pa platforma, hekura mbajtës, lavamanë dhe tualete në lartësi të përshtatshme për përdoruesit e karrigeve me rrota, dhe sipërfaqja e dhomave të banjës dhe tualetit e përshtatshme për karriget me rrota.
			1.4. Siguria
	11.2. Janë prezantuar masa të përshtatshme sigurie, bazuar në rezultatin e vlerësimit të rrezikut.		
	11.3. Ekziston mundësia të raportoni çështjet e sigurisë (p.sh. vjedhje, dhunë, kërcënime, agresivitet nga komuniteti i jashtë) ndaj personelit përgjegjës në një mënyrë të sigurt.		
	11.4. Numrat e telefonatave të emergjencës janë të afishuara në një vend të dukshëm dhe disponohet edhe një telefon.		
	11.5. Masat e sigurisë fokusohen në zbulimin dhe parandalimin e dhunës seksuale dhe atë me bazë gjinore.		
	11.6. Janë bërë sistemime specifike për aplikuesit me nevoja të veçanta.		

Standardet e punës dhe treguesit rreth kushteve të pranimit				
Seksioni	Nëseksioni	Standardi	Treguesi(t)	
1. Strehimi	1.5. Zonat e përbashkëta	12. Sigurohuni që aplikuesit të kenë vend të mjaftueshëm për të ngrënë.	12.1. Të gjithë aplikuesit kanë mundësinë të hanë në një vend të caktuar.	
		13. Sigurohuni që të gjithë aplikuesit të kenë hapësirë të mjaftueshme për aktivitete në kohën e lirë dhe në grup.	13.1. Një zonë e përshtatshme për aktivitetet në kohën e lirë ekzistojnë brenda vendit të strehimit ose brenda hapësirës publike pranë.	
			13.2. Aty ku aktivitetet në grup organizohen nga Shteti Anëtar, disponohet hapësirë e mjaftueshme.	
			13.3. Nëse ambienti strehon fëmijë, ekziston një dhomë/zonë e sigurt që ata të luajnë dhe të përfshihen në aktivitete në ajër të pastër, brenda vetë strehimit ose në një hapësirë publike pranë.	
		1.6. Pastërtia	14. Sigurohuni që zonat private dhe të përbashkëta të qëndrojnë të pastra.	14.1. Ambienti i strehimit zbaton një grafik pastrimi
				14.2. Pastërtia e zonave private dhe të përbashkëta të strehimit kontrollohet rregullisht.
	14.3. Pastërtia kontrollohet kur personat kalojnë në një dhomë tjetër ose në një ambient tjetër strehimi.			
	14.4. Aty ku aplikuesit janë përgjegjës për pastrimin, ata kanë qasje në produktet dhe artikujt e nevojshëm të pastrimit, si dhe në pajisjet mbrojtëse, të tilla si dorezat dhe maskat.			
	15. Sigurohuni që kuzhina dhe zonat sanitare të qëndrojnë të pastra.		15.1. Pastërtia e zonave është në përputhje me standardet dhe rregulloret vendore dhe kombëtare.	
			15.2. Zonat pastrohen të paktën çdo ditë (në qendrat e akomodimit) ose aq shpesh sa nevojitet.	
			15.3. Pastrimi në thellësi i zonave kryhet rregullisht.	
	16. Sigurohuni që aplikuesit të mund t'i lajnë vetë rrobat e tyre ose t'i dërgojnë për larje rregullisht.		16.1. Kur ofrohen në natyrë çarçafë krevatesh dhe peshqirë dhe ato lahen nga ambienti i strehimit, ato duhet të lahen rregullisht.	
		16.2. (a): Aplikuesit duhet të jenë në gjendje të lajnë rrobat të paktën një herë në javë; OSE 16.2. (b): Disponohet një shërbim larjeje rrobash për aplikuesit.		

Standardet e punës dhe treguesit rreth kushteve të pranimit				
Seksioni	Nënseksioni	Standardi	Treguesi(t)	
1. Strehimi	1.7. Mirëmbajtja	17. Garantonit sigurinë dhe funksionimin e duhur të ambienteve të strehimit nëpërmjet mirëmbajtjes së rregullt.	17.1. Funksionimi i mirë i vendit të strehimit dhe mobilieve dhe pajisjeve të tij vlerësohet rregullisht.	
			17.2. Aplikuesit kanë mundësinë që të raportojnë nëse ka nevojë për mirëmbajtje dhe riparime.	
			17.3. Riparimet dhe zëvendësimet e nevojshme brenda vendit të strehimit kryhen në kohë dhe me standardin e duhur.	
	1.8. Pajisjet dhe shërbimet e komunikimit	18. Sigurohuni që aplikuesit të kenë qasje të përshtatshme të telefonit për të bërë thirrje në lidhje me çështjet procedurale, ligjore, mjekësore ose arsimore.	18.1. Qasja në telefon është i mundur të paktën për thirrje në lidhje me çështjet procedurale, ligjore, mjekësore dhe arsimore.	
			18.2. Aplikuesit kanë qasje të përditshme në të paktën një telefon për njësi strehimi.	
			18.3. Aplikuesit mund të kryejnë thirrje në një ambient privat, pra aplikuesit e tjerë nuk mund ta dëgjojnë bisedën.	
			19.1. Aplikuesit kanë qasje në internet në vetë vendin e strehimit ose në një hapësirë publike pranë, të paktën katër herë në javë.	
		20. Sigurohuni që aplikuesit të kenë mundësi të ngarkojnë pajisjet e tyre të komunikimit.	20.1. Ekziston të paktën një prizë e disponueshme dhe e arritshme për dhomë gjumi, në mënyrë që të ngarkohen pajisjet elektronike.	
	2. Ushqimi	21. Sigurohuni që aplikuesit të kenë qasje në ushqim të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm.	21. Sigurohuni që aplikuesit të kenë qasje në ushqim të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm.	21.1. Zbatohen standardet e sigurisë së ushqimit.
				21.2. Të paktën tre vakte në ditë serviren për të rriturit dhe pesë për të miturit, nga të cilat të paktën njëra gatuhet dhe serviret e ngrohtë.
21.3. Vaktet sigurojnë një dietë të ekuilibruar dhe me variacion.				
21.4. Aplikuesit informohen rreth përbërjes së vaktit.				
21.5. Janë bërë plane specifike për aplikuesit me nevoja të veçanta diete.				
21.6. Merren parasysh edhe preferencat e ngrënies dhe kufizimet në dietë për grupe specifike.				
22. Sigurohuni që aplikuesit të kenë qasje në ujë të pijshëm pa ndalim.		22. Sigurohuni që aplikuesit të kenë qasje në ujë të pijshëm pa ndalim.	22.1. Secilit aplikues i ofrohen minimalisht 2,5 litra ujë në ditë, ndërkohë që merren parasysh dhe nevoja fiziologjike personale dhe klima.	
			22.2. (a): Infrastruktura e vendit të strehimit është e përshtatshme për ujë të pijshëm. OSE	
			22.2. (b): Në mungesë të infrastrukturës së përshtatshme, uji i pijshëm shpërndahet.	

Standardet e punës dhe treguesit rreth kushteve të pranimit			
Seksioni	Nënseksioni	Standardi	Treguesi(t)
3. Veshjet dhe artikujt e tjerë joushqimorë	23.	Sigurohuni që aplikuesi të ketë veshje të mjaftueshme.	23.1. Aplikuesi ka veshje të brendshme të mjaftueshme për një javë, pa pasur nevojë të lajë rroba.
			23.2. Aplikuesi ka të paktën një numër minimal artikujsh veshjeje.
			23.3. Aplikuesi ka të paktën dy palë të ndryshme këpucësh.
			23.4. Aplikuesve u ofrohen veshje sa më shpejt që të jetë e mundur.
			23.5. Nëse ndonjë veshje nuk përdoret më si rezultat i konsumimit dhe grisjes, ka një mënyrë të standardizuar për ta shkëmbyer me një artikull tjetër.
			23.6. Aplikuesit kanë veshje të mjaftueshme për bebet dhe fëmijët e vegjël për 1 javë, pa pasur nevojë të lajnë rrobat.
	24.	Sigurohuni që aplikuesit të ketë veshje të përshtatshme.	24.1. Veshjet u përshtaten mjaftueshëm aplikuesve për sa i përket madhësisë.
			24.2. Veshjet janë mjaftueshëm të paraqitshme dhe të përshtatshme me standardin e përgjithshëm të shoqërisë pritëse dhe me prejardhjen kulturore të aplikuesve.
			24.3. Disponohen veshje sezonale të përshtatshme.
	25.	Sigurohuni që aplikuesit të kenë qasje në produkte higjienë personale të mjaftueshme dhe të përshtatshme.	25.1. Ekziston një listë që specifikon llojin dhe sasinë e produkteve të higjienës personale që kanë të drejtë të marrin aplikuesit e një moshe dhe gjinie të caktuar.
			25.2. Produktet e domosdoshme të higjienës personale vihen në dispozicion të aplikuesve, ose nëpërmjet shpërndarjes në natyrë sipas numrit të personave, ose nëpërmjet dietës së shpenzimeve të përditshme.
	26.	Sigurohuni që aplikuesit të kenë qasje në artikujt e tjerë thelbësorë joushqimorë	26.1. Ofrohen çarçafë dhe peshqirë të mjaftueshëm.
			26.2. Disponohet pluhur larës nëse aplikuesit janë përgjegjës për larjen e rrobave të tyre.
			26.3. Janë vendosur sisteme specifike për aplikuesit me nevoja të veçanta.
	27.	Sigurohuni që fëmijëve të regjistruar në shkollë t'u ofrohen veshje të përshtatshme dhe aksesori shkollor, që t'i ndihmojnë ata të marrin pjesë plotësisht në aktivitetet edukative të shkollës.	27.1. Fëmijëve që ndjekin arsimin e detyrueshëm në shkollë u ofrohen veshje të përshtatshme për aktivitetet shkollorë.
			27.2. Fëmijët që ndjekin shkollën marrin falas një çantë shkolle (çantë shpine ose tjetër) dhe të gjitha artikujt (librat e shkollës etj.) që kërkohen nga shkolla.

Standardet e punës dhe treguesit rreth kushteve të pranimit			
Seksioni	Nënseksioni	Standardi	Treguesi(t)
4. Dieta për shpenzimet ditore		28. Sigurohuni që të ofrohet një dietë e përshtatshme për shpenzimet ditore.	28.1. Ekziston një përkufizim i qartë i objektivit të dietës për shpenzimet ditore.
			28.2. Metoda e qarkullimit të dietës për shpenzimet ditore është përcaktuar qartë.
			28.3. Dieta për shpenzimet ditore ofrohet në dispozicion të plotë (“para xhepi”) dhe i lejon aplikuesit të fitojnë një shkallë të përshtatshme autonomie.
			28.4. Shuma e dietës për shpenzime ditore reflekton gjithashtu minimalisht shpenzimet e mëposhtme, përveç rastit kur sigurohen në natyrë: komunikimin dhe informacionin, artikujt shkollorë, higjienën personale dhe kujdesin për trupin, aktivitetet e kohës së lirë dhe kostot për transportin kur bëhet fjalë për qasjen në kujdesin shëndetësor dhe përfitimin e mjekimeve, procedurën e azilit dhe ndihmën ligjore dhe arsimimin për fëmijët e regjistruar në shkollë.
			28.5. Dieta për shpenzimet ditore ofrohet rregullisht dhe jo më pak se një herë në muaj për sa i përket “parave të xhepit”.
5. Kujdesi shëndetësor		29. Garantoni qasjen në kujdesin e nevojshëm shëndetësor, të paktën në nivel emergjence dhe trajtim thelbësor të sëmundjeve dhe çrregullimeve të rënda mjekësore.	29.1. Aplikuesi ka qasje në të gjitha llojet e shërbimeve të nevojshme të kujdesit shëndetësor.
			29.2. Shërbimet e kujdesit shëndetësor ofrohen nga personel mjekësor i kualifikuar.
			29.3. Kujdesi mjekësor disponohet brenda vendit të strehimit ose jashtë në një distancë të arsyeshme.
			29.4. Kujdesi i domosdoshëm shëndetësor, përfshi mjekimin e përshkruar, ofrohet falas ose kompensohet ekonomikisht nëpërmjet dietës për shpenzime ditore.
			29.5. Janë vendosur plane të përshtatshme për t’u siguruar që aplikuesi mund të komunikojë me personelin mjekësor.
			29.6. Bëhen plane për të siguruar qasje në ndihmën e shpejtë në raste emergjente.
			29.7. Aplikuesit i ofrohet qasje në regjistrat e tij/saj mjekësorë, pa shpërfillur legjislacionin kombëtar.
			29.8. Janë vendosur plane specifike për aplikuesit me nevoja të veçanta mjekësore.

Standardet e punës dhe treguesit rreth kushteve të pranimit			
Seksioni	Nëseksioni	Standardi	Treguesi(t)
6. Ofrimi i informacionit dhe këshillimi	30.	Sigurohuni që aplikuesi të marrë dhe të kuptojë informacionin që lidhet me fazën, për përfitimet dhe detyrimet në lidhje me kushtet e pranimit.	30.1. Informacioni i shkruar ofrohet në një gjuhë që aplikuesi e kupton ose që supozohet në mënyrë të arsyeshme që e kupton.
			30.2. Aty ku nevojitet dhe është e përshtatshme, informacioni ofrohet edhe verbalisht, në një gjuhë që aplikuesi e kupton.
			30.3. Informacioni mbulon të gjitha aspektet e kushteve të pranimit, përfshirë përfitimet dhe detyrimet sipas RCD-së.
			30.4. Informacioni ofrohet në kohë (maksimumi në 15 ditë) pas paraqitjes së një aplikacioni për mbrojtje ndërkombëtare.
			30.5. Informacioni ofrohet sipas nevojave të veçanta dhe rrethanave individuale të aplikuesve.
	31.	Sigurohuni që ofrimi i informacionit ose organizatave ose grupeve të personave që ofrojnë ndihmë të posaçme ligjore dhe organizatave që mund t'ju ndihmojnë ose të njoftojnë aplikuesit rreth kushteve të pranimit, përfshirë kujdesin shëndetësor.	31.1. Për aplikuesit ofrohet informacion rreth ndihmës ligjore të disponueshme dhe mënyrës se si të qasesh.
			31.2. Informacioni që u ofrohet aplikuesve përfshin të dhënat e kontaktit të organizatave ose grupeve të personave që mund t'i njoftojnë aplikuesit rreth kushteve të pritjes që disponohen, përfshirë kujdesin shëndetësor dhe se si t'i qasen.
			31.3. Informacioni i shkruar ofrohet në një gjuhë që aplikuesi e kupton ose që supozohet në mënyrë të arsyeshme që e kupton.
			31.4. Aty ku nevojitet dhe është e përshtatshme, informacioni ofrohet edhe verbalisht, në një gjuhë që aplikuesi e kupton.
			31.5. Informacioni duhet të ofrohet në kohë (maksimumi në 15 ditë) pas paraqitjes së një aplikacioni për mbrojtje ndërkombëtare.
			31.6. Informacioni ofrohet sipas nevojave të veçanta dhe rrethanave personale të aplikuesve.

Standardet e punës dhe treguesit rreth kushteve të pranimit			
Seksioni	Nëseksioni	Standardi	Treguesi(t)
6. Ofrimi i informacionit dhe këshillimi		32. Garantoni qasjen e përshtatshme për këshilluesit ose konsulentët ligjorë, personat që përfaqësojnë UNHCR-në, Kryqin e Kuq, organizatat përkatëse ndërqeveritare dhe joqeveritare që njihen nga Shteti Anëtar në fjalë, në mënyrë që të ndihmoni aplikuesit.	32.1. Qasja e aktorëve të mësipërm kufizohet vetëm mbi arsyet që lidhen me sigurinë e ambienteve dhe të aplikuesve, me kusht që të mos jetë tejet i kufizuar ose të bëhet i pamundur.
			32.2. Aktorët e renditur më lart mund të takohen dhe të flasin me aplikuesit në kushte që sigurojnë privatësinë e duhur.
		33. Siguroni qasje në këshillimin social për aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare.	33.1. Këshillimi social disponohet për aplikuesit brenda ose jashtë ambientit të strehimit.
			33.2. Aplikuesit mund të kenë qasje në këshillimin social rregullisht dhe sipas nevojave të tyre personale.
7. Identifikimi, vlerësimi dhe reagimi ndaj nevojave të veçanta	34. Siguroni që të caktohet një mekanizëm për të identifikuar dhe vlerësuar nevojat e veçanta të pranimit.	34.1. Është caktuar një mekanizëm i standardizuar për të identifikuar dhe vlerësuar nevojat e veçanta të pranimit për çdo aplikues.	
		34.2. Mekanizmi përshkruan në qartësi se cili është përgjegjës për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të veçanta të pranimit.	
		34.3. Mekanizmi përshkruan qartësisht se si regjistrohen dhe i komunikohen identifikimi dhe regjistrimi aplikuesit dhe aktorëve përkatës.	
	35. Sigurohuni që mekanizmi për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të veçanta të pranimit të zbatohet me efikasitet.	35.1. Për të identifikuar, vlerësuar dhe monitoruar nevojat e veçanta caktohen burime të mjaftueshme.	
		35.2. Identifikimi dhe vlerësimi fillestar i nevojave të veçanta kryhet sa më shpejt që është e mundur.	
		35.3. Nevojat e veçanta, të cilat bëhen të dukshme në një etapë të mëvonshme, identifikohen dhe vlerësohen në mënyrë të përshtatshme.	
		35.4. Aty ku është e përshtatshme, në vlerësimin e nevojave të veçanta përfshihen aktorë të specializuar.	
		35.5. Kanalet e komunikimit dhe bashkëpunimi ndërmjet autoritetit të pranimit dhe autoritetit të përcaktimit janë vendosur dhe përdoren.	
		35.6. Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të veçanta të pranimit kryhet pa shpërfillur ekzaminimin e nevojës së aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare.	



Standardet e punës dhe treguesit rreth kushteve të pranimit			
Seksioni	Nëseksioni	Standardi	Treguesi(t)
7. Identifikimi, vlerësimi dhe reagimi ndaj nevojave të veçanta		36. Sigurohuni që nevojat e veçanta të identifikuar të pritjes të trajtohen në kohë.	36.1. Ndërmerren masa të përshtatshme dhe të menjëhershme për t’u përgjigjur nevojave të veçanta të identifikuar dhe të vlerësuara.
			36.2. Në rast se janë identifikuar nevojat e veçanta, ekziston një mekanizëm për të siguruar monitorimin e tyre të rregullt.
8. Trajnimi i stafit		37. Sigurohuni që oficerët e pranimit të jenë të kualifikuar mjaftueshëm.	37.1. Secili oficer pranimit ka terma reference të qarta (përshkrim pune).
			37.2. Secili oficer pranimit është i kualifikuar në përputhje me ligjin dhe rregulloret kombëtare që lidhen me termat e tij/saj të veçantë të referencës (përshkrimin e punës).
	38. Sigurohuni që oficerëve të pranimit t’u ofrohet trajnimi i nevojshëm dhe i përshtatshëm.	38.1. Secili oficer pranimit ka një pjesë hyrjeje të plotë dhe në kohë për rolin e tij/saj, përfshirë për kodin e sjelljes në fuqi.	
		38.2. Ekziston një program i qartë trajnimi që përfshin kërkesat e trajnimit për çdo grup funksional.	
		38.3. Trajnimi ofrohet rregullisht dhe në varësi të nevojës.	
		38.4. Minimumi i trajnimit që ofrohet përfshin shqetësimet gjinore dhe specifike të moshës dhe situatën e aplikuesve me nevoja të veçanta, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve dhe sigurimin e standardeve për fëmijët, përfshirë fëmijët e pashoqëruar, si dhe identifikimin e viktimave të torturës dhe dhunës.	
39. Promovoni ndërgjegjësimin e grupeve të tjera të interesit që janë në kontakt të rregullt me aplikuesit.	39.1. Janë vendosur sesione të rregullta të rritjes së ndërgjegjësimit dhe/ose plane alternative për personat që nuk konsiderohen “oficerë pranimit”, por që sidoqoftë janë në kontakt me aplikuesit për shkak të profesionit/funksionit të tyre.		
40. Promovoni mbështetjen e procesit për oficerët e pranimit.	40.1. Disponohen masa të ndryshme për të ndihmuar në trajtimin e situatave të vështira që hasen gjatë punës së pranimit.		



## Getting in touch with the EU

### In person

All over the European Union there are hundreds of Europe Direct information centres. You can find the address of the centre nearest you at: [https://europa.eu/european-union/contact\\_en](https://europa.eu/european-union/contact_en)

### On the phone or by email

Europe Direct is a service that answers your questions about the European Union. You can contact this service:

- by freephone: 00 800 6 7 8 9 10 11 (certain operators may charge for these calls),
- at the following standard number: +32 22999696 or
- by email via: [https://europa.eu/european-union/contact\\_en](https://europa.eu/european-union/contact_en)

## Finding information about the EU

### Online

Information about the European Union in all the official languages of the EU is available on the Europa website at: [https://europa.eu/european-union/index\\_en](https://europa.eu/european-union/index_en)

### EU publications

You can download or order free and priced EU publications at: <https://op.europa.eu/en/publications>. Multiple copies of free publications may be obtained by contacting Europe Direct or your local information centre (see [https://europa.eu/european-union/contact\\_en](https://europa.eu/european-union/contact_en)).

### EU law and related documents

For access to legal information from the EU, including all EU law since 1952 in all the official language versions, go to EUR-Lex at: <http://eur-lex.europa.eu>

### Open data from the EU

The EU Open Data Portal (<http://data.europa.eu/euodp/en>) provides access to datasets from the EU. Data can be downloaded and reused for free, for both commercial and non-commercial purposes.



Publications Office  
of the European Union